

Politikat industriale të gjelbra: Analizë e kontekstit të Kosovës



Politikat industriale të gjelbra:
Analizë e kontekstit të Kosovës

2026

Deklaratë mohimi:

Ky raport u bë i mundur me mbështetjen e Open Society Foundation – Western Balkans. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Institutit GAP dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit.

Verzioni origjinal i këtij raporti është shkruar në gjuhën angleze.

Mbështetur nga:

OPEN SOCIETY
FOUNDATIONS
WESTERN BALKANS

— Përmbajtja

Shkurtesat	4
Përmbledhje ekzekutive	5
Metodologjia	7
1. Konteksti i tranzicionit energjetik dhe rëndësia strategjike e politikave industriale të gjelbra	9
1.1. Vështrim i përgjithshëm mbi sistemin energjetik	10
1.2. Zhvillimi i kapaciteteve nga burimet e ripërtëritshme	12
1.3. Sfidat në zhvillimin e kapaciteteve nga burime të ripërtëritshme të energjisë dhe nevoja për One-Stop Shops (OSS)	17
2. Mekanizmi i rregullimit të kufirit për karbon (CBAM) dhe ekspozimi tregtar	21
2.1. Zbatimi i mekanizmit CBAM	21
2.2. Ekspozimi sektorial ndaj CBAM-it	22
2.3. Disa implikime të CBAM në politika	28
3. Tranzicioni i drejtë, punësimi dhe aftësitë	29
3.1. Ndikimi rajonal dhe social	29
3.2. Kornizat e politikave dhe mbrojtja sociale	32
3.3. Rikualifikimi dhe zhvillimi i fuqisë punëtore	34
3.4. Masat sociale mbrojtëse dhe angazhimi i publikut	35
4. Financimi i tranzicionit energjetik	37
4.1. Nevojat për investime dhe hendeqet financiare	37
4.1.1 Roli i financimit publik dhe IFN-ve	39
4.1.2 Roli i financimit privat	40
5. Rekomandime	42
Shtojca	45

Shkurtesat

CBAM	Mekanizmi i rregullimit të kufirit për karbonin
KpD	Kontratë për diferencë
CO₂	Dioksid karboni
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
VNM	Vlerësimi i ndikimit në mjedis
BEI	Banka Evropiane e Investimeve
ZRRE	Zyra e Rregullatorit për Energji
EU ETS	Sistemi i BE-së për tregtimin e emetimeve
BE	Bashkimi Evropian
FKEE	Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë
BPV	Bruto produkti vendor
TEG	Tranzicion drejt ekonomisë së gjelbër
GS	Gazra serrë
GROW	Skema për rimëkëmbje dhe mundësi të gjelbra
GWh	Gigavat/orë
IFN	Institucione financiare ndërkombëtare
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IPA	Instrumenti i asistencës së para-anëtarësimit
NMVM	Ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
FKGK	Fondi Kosovar për Garanci Kreditore
KEDS	Kompania Kosovare për Distribuim të Energjisë Elektrike
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KfW	Kreditanstalt für Wiederaufbau
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut
ktoe	Kiloton ekuivalent naftë
kW	Kilovat
MCC	Millennium Challenge Corporation
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Mtoe	Milion ton ekuivalent naftë
MW	Megavat
MWth	Megavat termik
PKEK	Plani kombëtar për energji dhe klimë
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OSS	One-Stop Shop (pikë e vetme shërbimesh)
PPA/ MBE	Marrëveshje për blerje të energjisë
RED	Direktiva për energji nga burimet e ripërtëritshme
ZPBRE	Zona të përcaktuara për përshpejtim të zhvillimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë
BRE	Burime të ripërtëritshme të energjisë
NVM	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme
tCO₂eq	Ton ekuivalent CO ₂
BP	Ballkani Perëndimor
WBIF	Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor

Përmbledhje ekzekutive

Tranzicioni i gjelbër i Kosovës është shndërruar në një domosdoshmëri ekonomike, shoqërore dhe rregullatore. Vendi vazhdon të jetë shumë i varur nga prodhimi i energjisë elektrike me bazë linjitin, ndërkohë që infrastruktura e vjetruar e dy termocentraleve kryesore krijon rreziqe për furnizim adekuat me energji, siguri energjetike, dëmtim të mjedisit përmes emetimeve të gazrave serrë, probleme të shëndetit publik për shkak të ndotjes së ajrit, si dhe sfida në kuptim të përmbushjes së politikave klimatike të Bashkimit Evropian. Përkundër zgjerimit të kapaciteteve të energjisë nga burimet e ripërtëritshme gjatë viteve të fundit, kryesisht përmes energjisë së erës, hidrocentraleve dhe investimeve të kohëve të fundit në energji diellore, ritmi i shfrytëzimit të tyre ngelet i pamjaftueshëm në raport me objektivat energjetike dhe klimatike të Kosovës për vitet 2030 dhe 2050. Kjo krijon rreziqe të drejtpërdrejta për sigurinë energjetike, cilësinë e mjedisit, shëndetin publik, konkurrueshmërinë industriale dhe përafrimin me kornizat e Bashkimit Evropian për klimën dhe energjinë.

Kosova ka shënuar deri diku përparim në vendosjen e themeleve të politikave për dekarbonizim. Strategjia e Energjisë 2022–2031, Draft Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë 2025–2030, Ligji për ndryshimet klimatike, ankandet për energji nga burimet e ripërtëritshme dhe programet për efikasitet të energjisë ofrojnë një kornizë bazë për tranzicionin. Megjithatë, zbatimi po ecën me ritëm të ngadaltë. Kosova është ende larg përmbushjes së caqeve për energji nga burimet e ripërtëritshme, efikasitet të energjisë, sisteme të akumulimit të energjisë dhe vendosjen e tarifave për emetime të karbonit. Për më tepër, shumë masa të politikave të ndërmarra nga ministri të ndryshme nuk janë mjaftueshëm koherente apo të koordinuara, ndërsa bashkëpunimi ndërsektorial ndërmjet institucioneve vijon të jetë i kufizuar. Për këtë arsye, nevojitet një politikë industriale e gjelbër gjithëpërfshirëse që do të përbashkonte tranzicionin energjetik, modernizimin industrial, konkurrueshmërinë e eksporteve, instrumentet financiare, zhvillimin e fuqisë punëtore dhe mbrojtjen sociale në një kornizë të vetme strategjike.

Projektet e energjisë nga burimet e ripërtëritshme karakterizohen nga procedura të gjata të pajisjes me leje, kapacitete të kufizuara të rrjetit, pengesa që lidhen me çështjet pronësore dhe fragmentim të përgjgjësive institucionale. One-Stop Shop për investime në burime të energjisë së ripërtëritshme funksionon kryesisht si mekanizëm informimi e koordinimi, por nuk përputhet me kompetencat dhe kapacitetet e nevojshme operative për të siguruar respektimin e afateve, për të zvogëluar barrën administrative apo për të nxjerrë vendime të konsoliduara. Forcimi i këtij mekanizmi është thelbësor për përshpejtimin e investimeve në burime të ripërtëritshme të energjisë. Fondi i Kosovës për Efikasitet të Energjisë ka mbështetur projekte të efikasitetit të energjisë në ndërtesa publike dhe, përmes skemave të subvencionimit, objekte banimi, përfshirë izolimin termik, zëvendësimin e dyerve dhe dritareve, modernizimin e sistemeve të ngrohjes dhe masa të tjera. Këto ndërhyrje kanë përmirësuar performancën energjetike të objekteve dhe kanë ulur konsumin e energjisë, megjithatë niveli i investimeve ngelet i pamjaftueshëm, sidomos në sektorin e banimit që përfaqëson një përqindje të konsiderueshme të konsumit final të energjisë. Zgjerimi i rinovimeve për performancë më të mirë energjetike të objekteve banesore, efikasitetit të energjisë në industri dhe i modeleve të prosumatorëve do të kontribuonin në uljen e kërkesës për energji elektrike, reduktimin e faturave të energjisë, forcimin e sigurisë energjetike dhe mbështetjen e zhvillimit të një tregu vendor të shërbimeve të gjelbra.

Mekanizmi i rregullimit të kufirit për karbon paraqet një sfidë të re për konkurrueshmërinë e eksportuesve kosovarë. CBAM u bë plotësisht operacional në vitin 2026 dhe zbatohet për importet drejt Bashkimit Evropian të mallrave me intensitet të lartë emetimi të karbonit, si hekuri dhe çeliku, alumini, çimentoja, plehurat kimike, energjia elektrike dhe hidrogjeni. Eksportet e Kosovës drejt BE-së

për të cilat zbatohet CBAM janë relativisht të kufizuara në vlerë totale, por kanë përqendrim të lartë në sektorët e hekurit dhe çelikut, si dhe të aluminit. Në vitin 2025, eksportet për të cilat zbatohet CBAM arrijnë vlerën prej rreth 37.6 milionë eurosh, që përfaqëson afërsisht 12% të eksporteve të përgjithshme të Kosovës drejt BE-së, ku hekuri dhe çeliku përbëjnë rreth 72% të këtyre eksporteve, kurse alumini rreth 27%. Rreziku kryesor nuk lidhet vetëm me vëllimin tregtar, por edhe me barrën e përmbushjes së kërkesave dhe me tarifën për emetimin e karbonit që u ngarkohen eksportuesve dhe partnerëve të tyre në BE. Gjetjet e këtij raporti tregojnë se niveli i ndërgjegjësimit dhe i përgatitjes së bizneseve në Kosovë vijon të jetë i kufizuar. Intervistat me eksportues shpalosin se shumë kompani nuk kanë marrë informata të strukturuar, trajnime apo udhëzime të drejtpërdrejta nga institucionet publike lidhur me raportimin sipas kërkesave të CBAM, llogaritjen e emetimeve të inkuorporuara në produkte apo kërkesat për verifikim. Disa kompani kanë filluar të investojnë në energji solare, kryesisht për t'i ulur kostot e energjisë elektrike pas liberalizimit të tregut, por këto investime janë financuar kryesisht nga vetë kompanitë. Mungesa e një mekanizmi vendor për tarifimin e emetimeve të karbonit krijon ekspozim shtesë për Kosovën. Meqenëse aktualisht nuk zbatohet asnjë taksë karboni apo sistem i tregtimit të emetimeve, prodhuesit kosovarë nuk mund të zbrisin tarifën vendore për emetimin e karbonit nga detyrimet sipas CBAM. Si rezultat, kostot që lidhen me emetimet e karbonit duhet të paguhen përmes sistemit të BE-së, në vend se të mbahen brenda vendit dhe të rinvestohen në tranzicionin e Kosovës. Vonesat në përgatitjen e mekanizmave për tarifimin e emetimeve të karbonit rrisin gjithashtu edhe pasigurinë rregullatore, ulin besimin e investitorëve dhe e ndërllojnë integritimin e ardhshëm të tregut të energjisë elektrike me BE-në. Një udhërrëfyes i hartuar me kujdes për zbatimin gradual të tarifimit të emetimeve të karbonit do t'i mundësonte Kosovës të përgatitej për përafrimin me BE-në, duke i përdorur të hyrat e ardhshme për financimin e dekarbonizimit industrial, burimeve të ripërtëritshme të energjisë, efikasitetit të energjisë, ekonomive familjare të cenueshme dhe masave për tranzicionin të drejtë.

Tranzicioni ka edhe një dimension të fuqishëm social dhe të tregut të punës. Kosova ende nuk ka hartuar një udhërrëfyes gjithëpërfshirës për tranzicionin të drejtë, pavarësisht përqendrimit të punësimit dhe varësisë ekonomike nga thëngjilli, minierat dhe aktivitetet e ndërlidhura me sektorin energjetik, veçanërisht në Obiliq dhe komunat përreth. Konsultimet me komunitetet shpalosin shqetësime për sa i përket ndotjes, përfitimeve të kufizuara lokale në kuptim të punësimit, shkallë të ulët besimi në proceset e vendimmarrjes dhe nevojë për mbështetje më të fuqishme për ekonomitë familjare të prekura. Përvoja ndërkombëtare dëshmon se në rajonet e varura nga thëngjilli nevojitet planifikim i hershëm, rikualifikim, masa aktive të tregut të punës, mbrojtje sociale dhe diversifikim ekonomik rajonal. Prandaj, Kosova duhet të hartojë një udhërrëfyes kombëtar për tranzicionin të drejtë, që ndërthur politikën për energjinë me punësimin, aftësimin profesional, zhvillimin rajonal dhe dialogun social.

Një nga vështirësitë kryesore për tranzicionin e gjelbër është financimi. Strategjia e Energjisë së Kosovës vlerëson se gjatë dhjetë viteve të ardhshme do të nevojiten rreth 3.06 miliardë euro investime, përfshirë rreth 1.3 miliardë euro për zhvillim të kapaciteteve të reja të burimeve të ripërtëritshme, 390 milionë euro për rehabilitim të termocentraleve ekzistuese me thëngjill, 350 milionë euro për efikasitet të energjisë, 200 milionë euro për sisteme të akumulimit të energjisë dhe për investime shtesë në rrjetet energjetike, sistemet e ngrohjes dhe mbrojtjen e konsumatorëve të cenueshëm. Drafti i Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë identifikon gjithashtu nevojën të konsiderueshme financiare për një periudhë më të shkurtër pesëvjeçare, ku burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe rehabilitimi i termocentraleve përbëjnë kategoritë më të mëdha të investimeve. Këto shifra dëshmojnë se Kosova e ka të pamundur që ta financojë tranzicionin vetëm me fonde publike. Për këtë arsye, nevojitet një qasje e financimit të kombinuar që ndërthur buxhetin publik, grante

nga donatorët, financim nga institucionet financiare ndërkombëtare, kreditim komercial, investime private dhe instrumente të garancisë.

Në këtë kontekst, është e domosdoshme të rriten kapacitetet financuese dhe të forcohet koordinimi ndërmjet institucioneve publike të financimit. Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë duhet të kapitalizohet më tej dhe të pozicionohet si institucion qendror për rinovimin e objekteve publike dhe banesore. Fondi Kosovar për Garanci Kreditore duhet t'i zgjerojë skemat e garancive për investime të gjelbra për NVM-të që investojnë në eficiencë të energjisë, burime të ripërtëritshme të energjisë dhe teknologji me emetime të ulëta karboni. Banka Zhvillimore e planifikuar, nëse themelohet, duhet të ketë mandat të qartë për financimin e projekteve të gjelbra, me fokus në burimet e ripërtëritshme të energjisë, dekarbonizimin industrial, gatishmërinë për CBAM, qëndrueshmërinë klimatike, infrastrukturën komunale dhe projektet që nuk mbështeten mjaftueshëm nga bankat komerciale.

Ky raport përmbillet me një sërë rekomandimesh konkrete dhe fokusuara për zbatim. Ndër veprimet kryesore që duhet të ndërmerren janë forcimi i procedurave të pajisjes me leje për energji nga burimet e ripërtëritshme, miratimi i legjislacionit të pamiruar për energjinë dhe klimën, zgjerimi i mbështetjes për eficiencë të energjisë, krijimi i infrastrukturës për pajtueshmëri me CBAM, përmirësimi i kapaciteteve të verifikimit dhe forcimi i mbrojtjes sociale për ekonomitë familjare të cenueshme. Krahas këtyre, Kosova duhet të hartojë një politikë industriale të gjelbër koherente, të zgjerojë ankandet për burime të ripërtëritshme të energjisë dhe skemat e prosumatorëve, të investojë në rrjete dhe sisteme të akumulimit të energjisë, të krijojë një Fond për Tranzicion të Drejtë, të përdorë financim të kombinuar, të zgjerojë programet për zhvillimin e aftësive të gjelbra dhe të vendosë masa të tranzicionit në tregun e punës. Përfundimisht, Kosova duhet ta ulë varësinë strukturore nga linjiti, të hartojë një udhërrëfyes vendor për tarifimin e emetimeve të karbonit, të forcojë integrimin e tregut të energjisë elektrike, të diversifikojë rajonet e varura nga thëngjilli dhe të harmonizohet plotësisht me kornizat e BE-së dhe të Komunitetit të Energjisë.

Metodologjia

Ky raport përdor një qasje metodologjike të kombinuar, që ndërthur analizën sasiore dhe cilësore për të vlerësuar implikimet e politikave industriale të gjelbra në Kosovë. Komponenti sasior mbështetet në të dhëna të siguruara nga Zyra e Rregullatorit për Energji, Dogana e Kosovës, Agjencia e Statistikave të Kosovës, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Korporata Energjetike e Kosovës dhe institucione të tjera përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare. Të dhënat tregtare të Doganës së Kosovës për periudhën 2021–2025 janë analizuar për të vlerësuar ekspozimin e Kosovës ndaj sektorëve të prekur nga CBAM, me vëmendje të veçantë ndaj eksporteve të hekurit dhe çelikut, aluminit, energjisë elektrike, çimentos dhe plehrave drejt Bashkimit Evropian. Veç kësaj, janë përdorur të dhënat e punësimit sipas sektorëve dhe komunave, që burojnë nga regjistrimi i fundit i popullsisë i realizuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, për të identifikuar përqendrimin gjeografik të punësimit në sektorët e energjisë, minierave dhe sektorëve tjerë të ndërlidhur, si dhe për të shqyrtuar implikimet e mundshme rajonale dhe sociale të dekarbonizimit dhe tranzicionit të gjelbër.

Për ta mbështetur analizën sasiore, studimi shqyrton edhe dokumente kombëtare dhe ndërkombëtare të politikave, korniza ligjore dhe plane strategjike që lidhen me politikat për klimën, tranzicionin energjetik, tregun e punës, dekarbonizimin industrial dhe parimet e tranzicionit të drejtë. Këtu përfshihen legjislacioni i Bashkimit Evropian, detyrimet që rrjedhin nga Komuniteti i Energjisë, Strategjia e Energjisë së Kosovës 2022–2031, Plani kombëtar për energji dhe klimë, si dhe dokumente të tjera përkatëse të politikave dhe kuadrit rregullator. Krahas kësaj janë zhvilluar

edhe disa intervista gjysmë të strukturuar me biznese që veprimtarinë e tyre e ushtrojnë në sektorë të cilët eksportojnë mallra të prekura drejtpërdrejt nga CBAM, veçanërisht prodhues të hekurit, çelikut dhe aluminit, produkte që përbëjnë pjesën më të madhe të eksporteve të Kosovës për të cilat zbatohet CBAM. Është realizuar dhe një intervistë me përfaqësues të Odës Ekonomike të Kosovës (OEK) për t'i evidentuar më mirë pikëpamjet e sektorit privat sa i përket ndërgjegjësisimit për CBAM, gatishmërisë për përmbytjen e kërkesave, si dhe sfidave dhe mundësive që sjell përshtatja ndaj rregulloreve klimatike të BE-së që po evoluojnë vazhdimisht. Më tej, raporti paraqet gjetje nga aktivitetet e konsultimit me komunitetet në Obiliq dhe Vushtrri, dy komuna të lidhura ngushtë me zhvillimet në sektorin energjetik të Kosovës që pritet të ndikohen nga angazhimet e ardhshme për dekarbonizim. Konsultimet kanë shërbyer për të mbledhur këndvështrime lokale mbi sfidat e tranzicionit energjetik, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje, nevojat për punësim dhe aftësi, ndikimet mjedisore dhe masat e mbrojtjes sociale.

Raporti trajton disa nga temat kryesore të Kornizës Rajonale të Politikës Industriale të Gjelbër (GIP), të lidhura me përsheptimin e tranzicionit energjetik dhe industrial. Megjithatë, ai nuk synon të jetë gjithëpërfshirës, duke u përqendruar në disa fusha kryesore, ndërsa pranon se ekzistojnë aspekte të tjera të rëndësishme, si çështjet mjedisore, roli i grave në procesin e tranzicionit dhe dimensione të tjera të ndërlidhura, të cilat kërkojnë shqyrtim të mëtejshëm.

Shtyllat e politikave industriale të gjelbra në rajon	Përputhja e prioriteteve të Kosovës me kornizën rajonale të politikave industriale të gjelbra
Tranzicioni drejt energjisë së pastër	Prioritetet përfshijnë përsheptimin e zhvillimit të energjisë së ripërtëritshme, forcimin e rrjetit elektrik dhe përmirësimin e eficiencës së energjisë (Pjesa 1).
Gatishmëria për CBAM	Raporti trajton çështjen e zhvillimit të çmimeve të karbonit, raportimit të emetimeve dhe gatishmërisë institucionale për CBAM (Pjesa 2).
Konkurrueshmëria industriale	Zhvillimi i industrisë së gjelbër, inovacioni dhe eficienca e burimeve identifikohen si faktorë kyç të konkurrueshmërisë (Pjesa 2).
Financimi i gjelbër	Trajtohen çështjet e zgjerimit të qasjes në financim të gjelbër dhe mobilizimit të investimeve publike dhe private (Pjesa 4).
Aftësitë dhe fuqia punëtore	Raporti thekson nevojën për zhvillimin e aftësive të gjelbra dhe rikualifikimin e fuqisë punëtore (Pjesa 3).
Tranzicioni i drejtë	Masat synojnë mbështetjen e familjeve të cenueshme, punëtorëve dhe komuniteteve gjatë tranzicionit të gjelbër (Pjesa 3).
Integrimi në BE dhe përafrimi rregullator	Trajtohet harmonizimi i prioriteteve të Kosovës me Marrëveshjen e Gjelbër të BE-së, Kornizën e Komunitetit të Energjisë dhe procesin e anëtarësisimit në BE (Pjesët 1 dhe 3).

1. Konteksti i tranzicionit energjetik dhe rëndësia strategjike e politikave industriale të gjelbra

Kosova, si vend tejet i varur nga energjia elektrike e prodhuar nga thëngjilli, ku rreth 90% e prodhimit të energjisë elektrike vjen nga ky burim, përballet me sfida të mëdha në procesin e tranzicionit energjetik. Infrastruktura e vjetruar e dy termocentraleve kryesore krijon rreziqe për sigurinë energjetike, dëmton mjedisin përmes emetimeve të gazrave serrë, shkakton probleme të shëndetit publik për shkak të ndotjes së ajrit dhe vështirëson përafrimin me politikat klimatike të Bashkimit Evropian. Sfidë tjetër për ekonominë e Kosovës është ekspozimi i eksportuesve vendorë të produkteve me intensitet të lartë të emetimeve të karbonit ndaj Mekanizmit të BE-së të rregullimit të kufirit për karbon (CBAM), që shton rrezikun e humbjes së konkurrueshmërisë në tregjet e BE-së. Në të njëjtën kohë, konkurrueshmëria industriale e ndërmarrjeve prodhuese vendore dobësohet nga kostot e larta të prodhimit, të cilat lidhen me përdorimin e teknologjive joefikase dhe me mungesën e investimeve në teknologji të gjelbra dhe efikasitet të energjisë. Kur merren parasysh përvoja dhe aftësitë e punëtorëve dhe komuniteteve në sektorin e energjisë së bazuar në thëngjill, vërehet një mospërputhje ndërmjet aftësive aktuale të fuqisë punëtore dhe kërkesave të sektorëve të rinj të gjelbër si burimet e ripërtëritshme të energjisë, teknologjitë e akumulimit të energjisë në bateri, shërbimet e efikasitetit të energjisë dhe ekonomia qarkore. Prandaj, sistemet e arsimit dhe aftësimin profesional duhet të përafrohen më mirë me nevojat e vendeve të ardhshme të punës në ekonominë e gjelbër.¹

Këto sfida mund të adresohen me hartimin dhe zbatimin e një politike industriale të gjelbër (PIGJ), e cila do të mbështeste tranzicionin energjetik dhe dekarbonizimin e Kosovës, përafrimin me politikat klimatike të BE-së, e njëherazi edhe krijimin e mundësive të reja ekonomike dhe rritjen e konkurrueshmërisë. Kjo mund të arrihet përmes instrumenteve fiskale, granteve dhe subvencioneve, siç janë subvencionimi i investimeve në efikasitet të energjisë, rritja e financimit për projekte të prodhimit të energjisë, përdorimi i marrëveshjeve për blerje të energjisë (MBE) të bazuara në ankande dhe kontratave për diferencë (KpD) që i mbrojnë prodhuesit nga rreziqet e tregut, si edhe krijimi i programeve të aftësimin për vende pune të gjelbra.

Investimet në burime të ripërtëritshme të energjisë dhe largimi gradual nga prodhimi i energjisë elektrike nga thëngjilli do ta përmirësonin sigurinë energjetike, do të ulnin emetimet e gazrave serrë dhe ndotjen e ajrit, si dhe do të zvogëlonin problemet shëndetësore që shkaktohen nga ndotja. Njëkohësisht, zbatimi i masave efektive për efikasitet të energjisë në industri dhe ndërtesa do të ulte konsumin e energjisë dhe kostot e prodhimit. Për më tepër, investimet në burime të ripërtëritshme të energjisë dhe në masa të efikasitetit të energjisë do të mund të krijojnë vende pune më produktive dhe më të paguara. Përmes këtyre investimeve dhe zotimeve, Kosova do të mund të tërhiqte investime të huaja nga kompani evropiane që synojnë ta afrojnë prodhimin më pranë tregjeve të tyre dhe të diversifikojnë zinxhirët e furnizimit.²

Politika industriale e gjelbër do të kishte rol të rëndësishëm edhe në adresimin e mospërputhjes së aftësive që mund të shfaqet gjatë tranzicionit. Duke i përafëruar institucionet arsimore dhe ofruesit e aftësimin profesional me nevojat e industrisë, punëtorët që varen nga industria e thëngjillit do të mund të fitonin aftësi të reja për vende pune të gjelbra dhe të përfitonin nga mundësitë e reja të punësimit që krijohen gjatë tranzicionit. Veç kësaj, Kosova ka mundësi të mëdha për zgjerimin e modeleve të prosumatorëve duke i mbështetur ekonomitë familjare dhe bizneset që ta prodhojnë vetë energjinë elektrike përmes paneleve solare, që do të ulte kostot e energjisë dhe do ta rriste pavarësinë energjetike. Të kombinuara me masat e efikasitetit të energjisë, këto mundësi mund të kontribuojnë edhe në uljen e varfërisë

¹ Instituti GAP. [Kornizë strategjike për politikat industriale të gjelbra në Ballkanin Perëndimor](#). 2025.

² Po aty.


energjetike dhe të shpenzimeve të ekonomive familjare. Orientimi drejt politikave të tilla mund t'ia lehtësojë Kosovës qasjen në fondet e BE-së, të institucioneve financiare ndërkombëtare dhe të donatorëve të tjerë të dedikuar për tranzicionin e gjelbër. Në këtë mënyrë, Kosova mund të sigurojë financim për zhvillimin e kapaciteteve të energjisë nga burimet e ripërtëritshme, modernizimin industrial, inovacionin, zhvillimin e fuqisë punëtore dhe përmirësimeve në mjedis.³

1.1. Vështrim i përgjithshëm mbi sistemin energjetik

Varësia e lartë e sistemit energjetik të Kosovës nga linjiti e rendit vendin ndër sistemet energjetike më të varura nga lëndët djegëse me prejardhje fosile në Evropë. Prodhimi i energjisë elektrike mbështetet kryesisht në dy termocentralet e vjetruara me linjit, Kosova A dhe Kosova B, të cilat vazhdojnë të sigurojnë pjesën dërrmuese të furnizimit vendor me energji elektrike. Historikisht, mbi 90% e energjisë elektrike në Kosovë është prodhuar nga thëngjilli, kurse kontributi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë ka qenë i kufizuar.⁴ Edhe në vitin 2025, linjiti përbënte pjesën dërrmuese të kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike në Kosovë. Nga kapaciteti i përgjithshëm operativ prej 1,261 MW, termocentralet me linjit përbënin 960 MW, ose rreth 76%. Pjesa tjetër prej 24% përbëhej nga kapacitetet energjetike të ripërtëritshme, përfshirë hidrocentralet, turbinat e erës dhe instalimet fotovoltaike. Në vitin 2025, kapaciteti i instaluar i hidrocentraleve ishte 128.5 MW, i centraleve me erë 137.2 MW, ndërsa kapaciteti fotovoltaik 35.5 MW.⁵

Gjatë periudhës 2018–2025, kapaciteti i përgjithshëm operativ për prodhim të energjisë elektrike në Kosovë u rrit nga rreth 1,076 MW sa ishte në vitin 2018 në 1,261 MW në vitin 2025. Është e rëndësishme të theksohet se kjo rritje u nxit pothuajse tërësisht nga investimet në kapacitete të energjisë nga burime të ripërtëritshme, ngaqë kapaciteti prodhues i termocentraleve me linjit mbeti i pandryshuar në 960 MW gjatë tërë periudhës. Në kuadër të investimeve në burime të ripërtëritshme, rritjen më të madhe e shënoi energjia e erës. Kapaciteti i instaluar u rrit nga 33.8 MW sa ishte në vitin 2018 në 137.2 MW në vitin 2025, falë vënies në funksion të një parku të ri me erë. Gjatë së njëjtës periudhë, kapaciteti hidroenergjetik u rrit nga 75.5 MW në 128.5 MW. Edhe energjia diellore, ndonëse nga një pikënisje shumë më e ulët, u rrit nga 6.6 MW sa ishte në vitin 2018 në 35.5 MW në vitin 2025, pas ndërtimit në vitin 2025 të gjashtë impianteve të reja fotovoltaike me kapacitet të kombinuar prej 21.5 MW. Si rezultat, pjesëmarrja e burimeve të ripërtëritshme të energjisë në kapacitetin e instaluar prodhues u rrit nga rreth 11% në vitin 2018 në afërsisht 24% në vitin 2025. Sidoqoftë, linjiti vazhdon të jetë burim dominues i kapaciteteve prodhuese të energjisë elektrike.⁶

Figura 1. Kapaciteti i përgjithshëm operativ prodhues i energjisë elektrike në Kosovë (MW), 2018–2025



Burimi: Zyra e Rregullatorit për Energji

³ Po aty.

⁴ OECD. [Çmimet dhe subvencionimi i energjisë elektrike në Ballkanin Perëndimor](#). 2025.

⁵ Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE). [Raport vjetor 2025](#).


⁶ Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE). [Raport vjetor 2018, 2019, 2020, 2021, 2022, 2023, 2024, 2025](#).

Gjatë periudhës 2018–2025, prodhimi vjetor i energjisë elektrike nga Kosova A dhe Kosova B u luhet ndërmjet rreth 4,687 GWh dhe 5,983 GWh, ndërkohë që prodhimi nga burimet e ripërtëritshme të energjisë varioi nga 303 GWh në 768 GWh. Në vitin 2025, Kosova A dhe Kosova B prodhuan afërsisht 4,687 GWh energji elektrike, që përbënte rreth 88.5% të prodhimit të përgjithshëm vendor. Po të njëjtin vit, nga burimet e ripërtëritshme u prodhuan rreth 612 GWh, ose 11.5% të prodhimit total, që përfaqëson rritje krahasuar me vitin 2018, kur burimet e ripërtëritshme përbënin më pak se 6% të prodhimit të përgjithshëm të energjisë elektrike. Rritja më e madhe e prodhimit nga këto burime u regjistrua gjatë periudhës 2021–2023, kryesisht si rezultat i vënies në funksion të projekteve të reja të energjisë së erës dhe integritit më të mirë të burimeve të ripërtëritshme të energjisë në sistem. Prodhimi nga burimet e ripërtëritshme arriti kulmin me afro 768 GWh në vitin 2023, pasuar nga një rënie në vitin 2024 për shkak të kushteve hidrologjike, megjithatë ai vazhdoi të qëndrojë dukshëm mbi nivelet historike.⁷

Sistemi energjetik i Kosovës mbështetet edhe në produkte të naftës dhe biomasë, kryesisht për nevoja të transportit dhe konsumit energjetik të ekonomive familjare.⁸ Kosova disponon rezerva të konsiderueshme të linjtit, të vlerësuara në rreth 12.5 miliardë tonë, ndër më të mëdhatë në Evropë. Vendi nuk ka prodhim vendor të naftës apo gazit natyror dhe aktualisht nuk disponon infrastrukturën e nevojshme për prodhimin e energjisë elektrike nga gazi.⁹

Megjithatë, gjatë viteve të fundit Kosova ka shënuar përparim gradual në tranzicionin energjetik, kryesisht përmes investimeve në energjinë e erës dhe atë diellore. Këto investime janë mbështetur nga korniza rregullatore vendore, përfshirë Strategjia për energji 2022–2031¹⁰, Draft Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë kombëtar për energji dhe klimë (PKEK)¹¹, si dhe nga përafrimi gjithnjë e më i madh me politikat klimatike dhe energjetike të Bashkimit Evropian. Miratimi i Ligjit për ndryshimet klimatike në janar të vitit 2024 krijoi një kornizë më të fuqishme të rregullimit klimatik dhe mbështet zbatimin e masave për dekarbonizim, përfshirë zgjerimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe zhvillimin e ardhshëm të mekanizmave për tarifimin e emetimeve të karbonit.¹²

Figura 2. Prodhimi kumulativ vjetor i energjisë elektrike (%)



Burimi: Zyra e Rregullatorit për Energji

Faktor tjetër që duhet të merret parasysh gjatë diversifikimit të strukturës së prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë është rregullimi dhe subvencionimi i

⁷ Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE). [Raport vjetor 2025](#).

⁸ German Watch. [Tranzicioni energjetik në Ballkanin Perëndimor](#). 2025.

⁹ Bankwatch Network. [Sektori i energjisë në Kosovë](#). 2024.

¹⁰ Ministria e Ekonomisë. [Strategjia për energji e Republikës së Kosovës 2022–2031](#).

¹¹ Qeveria e Kosovës. [Projektplan kombëtar për energji dhe klimë për Republikën e Kosovës 2025–2030](#).

¹² German Watch. [Tranzicioni energjetik në Ballkanin Perëndimor](#). 2025.

çmimeve të energjisë elektrike nga qeveria. Modeli aktual i subvencionimit i mban tarifat për konsumatorët nën nivelin e çmimit të tregut. Sipas vlerësimeve, para vitit 2023, çmimet e energjisë elektrike për ekonomitë familjare ishin rreth 40% më të ulëta se çmimet e tregut, kurse në vitin 2023 ato ishin afërsisht 90% më të ulëta se çmimet në tregjet ndërkombëtare. Një raport i OECD-së¹³ argumenton se, ndonëse këto subvencione kanë rol të rëndësishëm në zbutjen e varfërisë energjetike, ato nuk janë të orientuara mjaftueshëm drejt kategorive me nevojat më të mëdha dhe, si rrjedhojë, vlerësohet se 20% e ekonomive familjare më të varfra përfitojnë vetëm 8.2% të vlerës totale të mbështetjes për çmimin e energjisë elektrike. Kështu, çmimet e rregulluara mund të ulin motivimin për investime në efikasitet të energjisë dhe në burime të ripërtëritshme të energjisë. Për shkak të çmimeve relativisht të ulëta të energjisë elektrike, ekonomitë familjare dhe bizneset kanë më pak motivim që ta zvogëlojnë konsumin dhe të investojnë në teknologji që kursejnë energji. Ngjashëm, investitorët privatë mund të kenë më pak interes që të investojnë në burime të ripërtëritshme të energjisë, për shkak të pasigurisë lidhur me kthimin e ardhshëm të investimeve dhe konkurrencës nga energjia elektrike e subvencionuar. Përveç rregullimit të çmimeve, Kosova ka përdorur edhe subvencione për promovimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë përmes tarifave nxitëse (ang. feed-in tariffs), që garantonin çmime fikse për energjinë e prodhuar nga këto burime. Këto tarifa siguronin të hyra të garantuara dhe ulnin rrezikun për investitorët, duke u treguar efektive në nxitjen e investimeve në energji të ripërtëritshme.¹⁴

Megjithatë, gjetjet¹⁵ tregojnë se nevojitet reformim i politikës së çmimeve të energjisë elektrike dhe kalim drejt mekanizmave mbështetës më të orientuar kah tregu që do ta përmirësonin qëndrueshmërinë fiskale dhe do të mbështesnin tranzicionin e gjelbër. Vlerësohet se një rritje prej 19% e çmimeve të energjisë elektrike mund t'i sigurojë Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) mbi 90 milionë euro të hyra shtesë në vit. Për më tepër, çmimet më të larta do të nxisnin kursimin dhe do të ulnin nevojën për importe të kushtueshme të energjisë elektrike. Nga ana tjetër, subvencionet mund të orientohen më mirë drejt ekonomive familjare të cenueshme dhe atyre të rrezikuara nga varfëria. Në këtë mënyrë, subvencionimi i mirëfokusuar i energjisë elektrike, i kombinuar me mekanizma mbështetës të orientuar kah tregu për burimet e ripërtëritshme të energjisë (siç janë ankandet për energji të ripërtëritshme) do të mbështeste tranzicionin energjetik dhe procesin e dekarbonizimit në Kosovë.¹⁶

1.2. Zhvillimi i kapaciteteve nga burimet e ripërtëritshme

Kosova ka përcaktuar një sërë objektivash afatmesme dhe afatgjata (deri në vitin 2050) për dekarbonizimin dhe tranzicionin e sektorit të energjisë. Në nivel kombëtar, agjenda e saj e dekarbonizimit është formësuar nga dy dokumente kryesore: Strategjia për energji e Republikës së Kosovës 2022–2031¹⁷ dhe Draft Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK)¹⁸. Në nivel ndërkombëtar, Kosova është zotuar për zbatimin e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor¹⁹, caqeve të Komunitetit të Energjisë²⁰ dhe procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Strategjia kombëtare për energji e Republikës së Kosovës 2022–2031, e miratuar në vitin 2023, është dokumenti kryesor strategjik për sektorin e energjisë për një periudhë dhjetëvjeçare. Ajo përmban pesë objektiva kryesore strategjike: përmirësimi i besueshmërisë

13 OECD. [Çmimet dhe subvencionimi i energjisë elektrike në Ballkanin Perëndimor](#). 2025

14 Po aty.

15 Po aty.

16 Po aty.

17 Ministria e Ekonomisë. [Strategjia për energji e Republikës së Kosovës 2022–2031](#).

18 Qeveria e Kosovës. [Projektplan kombëtar për energji dhe klimë për Republikën e Kosovës 2025–2030](#).

19 Komisioni Evropian. [Udhëzime për zbatimin e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor](#). 2020.

20 Komuniteti i Energjisë. [Vendim i Këshillit Ministror nr. 2021/14/8MC të KE](#). 2022.

së sistemit, dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme, rritja e efikasitetit të energjisë, forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimit të tregut, si edhe mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorëve. Strategjia e identifikon zhvillimin e kapaciteteve të burimeve të ripërtëritshme të energjisë si mekanizëm kyç për largim gradual nga energjia e prodhuar nga linjiti dhe për uljen e emetimeve të gazrave serrë. Ajo parasheh masa për mbështetjen e ankandeve konkurruese për kapacitete të reja prodhuese nga burimet e ripërtëritshme, mbështetjen e prosumatorëve, zhvillimin e sistemeve të akumulimit të rezervës përmes baterive, fillimit e përdorimit të mekanizmave për tarifimin e emetimeve të karbonit dhe përmirësimin e efikasitetit të energjisë. Në kuadër të secilit objektiv strategjik, Strategjia përcakton objektiva specifike dhe caqe për vitin 2031, siç paraqitet në Tabelën 1.

Tabela 1. Strategjia për energji e Republikës së Kosovës 2022–2031 – Caqet kryesore të tranzicionit energjetik dhe dekarbonizimit

Objektivi	Caku (2031)	Progresi (2025)
Rritja e konsumit të energjisë elektrike nga BRE-të	Të paktën 35% e konsumit të energjisë elektrike të furnizohet nga burime të ripërtëritshme të energjisë	Konsumi i energjisë elektrike i mbuluar nga burime të ripërtëritshme është 8%
Rritja e kapacitetit të instaluar të BRE-ve	Arritja e rreth 1,600 MW kapacitet të instaluar nga burime të ripërtëritshme të energjisë	Kapaciteti i instaluar i burimeve të ripërtëritshme është 330 MW (përfshirë prosumatorët)
Ulja e emetimeve të gazrave serrë	Ulja e emetimeve të gazrave serrë nga sektori i energjisë me të paktën 32%	Emetimet e gazrave serrë janë ulur në 6,366 ktCO ₂ , +0.8%
Zhvillimi i sistemeve të akumulimit të energjisë	Instalimi i të paktën 170 MW kapacitet për akumulim të energjisë përmes baterive	Projekti për ndërtimin e sistemeve të akumulimit të energjisë përmes baterive është në proces me MCC-në
Rritja e efikasitetit të energjisë	Arritja e kursimeve kumulative të energjisë prej 232.5 ktoe në objekte banesore dhe komerciale, si dhe 33.6 ktoe në objekte publike	Kursimet kumulative në objekte banesore dhe komerciale janë 14.46 ktoe (2024), ndërsa në objekte publike 21.79 ktoe
Zgjerimi i ngrohjes qendrore	Rritja e kapacitetit të kogjenerimit nga ngrohja qendrore publike në 280 MWth	Kapaciteti i kogjenerimit nga ngrohja qendrore publike është 140 MWth
Fillimi i zbatimit të taksës së karbonit	Përcaktimi i bazës për një mekanizëm të tarifimit të emetimeve të karbonit të harmonizuar me EU ETS	Deri tani nuk është shënuar progres

Burimi: Ministria e Ekonomisë, Zyra e Rregullatorit për Energji

Përkundër rritjes graduale të kapaciteteve nga burimet e ripërtëritshme gjatë viteve të fundit, Kosova vazhdon të çalojë dukshëm në arritjen e caqeve për vitin 2031 të përcaktuara me Strategjinë për energjinë dhe ka pasur progres më të ngadaltë krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.²¹ Rritja më e madhe e kapaciteteve u shënuar në vitin 2021, me vënien në operim të parkut të erës "SOWI" me kapacitet 103 MW, duke e çuar kapacitetin e kombinuar të instaluar të centraleve me erë, hidrocentraleve dhe impianteve solare në rreth 275 MW.²² Sa i përket zhvillimit të kapaciteteve nga burimet e ripërtëritshme, Ministria e Ekonomisë përfundoi në vitin 2024 ankandin e parë konkurrues për një park solar me kapacitet 100 MW, me çmim të kontraktuar prej 48.88 euro/MWh.²³ Zbatimi i këtij projekti është mbështetur me një marrëveshje për blerje të energjisë (MBE), një marrëveshje afatgjatë kjo e lidhur ndërmjet prodhuesit dhe blerësit të energjisë për shitjen e energjisë me një çmim të parapërcaktuar. Ndërkohë, pas miratimit nga ZRRE, ka një

21 Agjencia Ndërkombëtare për Energjinë e Ripërtëritshme (IRENA). [Statistika për energjinë e ripërtëritshme 2025](#). 2025.

22 Zyra e Rregullatorit për Energji. [Raport vjetor 2025](#).

23 Burimi i Ripërtëritshëm i Energjisë në Kosovë (RESKosovo). [Ankandi i parë solar në Kosovë](#). 2024.

plan që kjo marrëveshje të shndërrohet në kontratë për diferencë (KpD).²⁴ KpD-të janë marrëveshje financiare me qeverinë që u ofrojnë siguri prodhuesve duke i mbrojtur këta të fundit nga humbjet që mund të shkaktohen nga luhatjet e çmimeve në treg.²⁵ Stimujt e tillë për investitorët, të kombinuar me politika industriale adekuate, do të ndihmonin në uljen e rreziqeve të investimit në sektor dhe në krijimin e të hyrave më të qëndrueshme për investitorët. Megjithatë, pavarësisht përfundimit të shumicës së procedurave administrative, ndërtimi i parkut nuk ka filluar akoma. Sipas Ministrisë së Ekonomisë, faza administrative është në përfundim, përfshirë këtu finalizimin e kontratave për projektim, prokurim dhe ndërtim, ndërsa Komuna e Rahovecit tashmë ka ndarë tokën për shfrytëzim afatgjatë. Nga sa raportohet, vonesat lidhen kryesisht me mosmarrëveshje ndërmjet investitorëve.²⁶ Në të njëjtën kohë kanë vazhduar përgatitjet për ankandin e një parku të erës me kapacitet 100 MW, ku Ministria e Ekonomisë ka nxjerrë thirrjen për dorëzimin e ofertave teknike dhe financiare në fund të vitit 2025, pas përfundimit të procesit të parakualifikimit.²⁷

Sa i përket objektivit për rritjen e efijencës së energjisë, gjatë viteve të fundit është shënuar progres gradual. Fondi i Kosovës për Efijencë të Energjisë, që nga themelimi i tij në vitin 2020, ka kontribuar në investime për rritjen e efijencës së objekteve publike përmes izolimit termik, zëvendësimit të dyerve dhe dritareve dhe modernizimit të sistemeve të ngrohjes. Progres është shënuar edhe në sektorin e banimit, ku skemat e subvencionimit për izolim, dritare me efijencë të lartë energjetike, pompa termike dhe teknologji të ngjashme kanë ndihmuar gati 4,000 ekonomi familjare që ta përmirësojnë performancën e tyre energjetike, duke arritur kursime energjie prej 14.46 ktoe. Sidoqoftë, pavarësisht këtyre investimeve, përmbushja e objektivës për rritjen e efijencës së energjisë, përkatësisht kursimeve prej 232.5 ktoe, vazhdon të jetë sfidë, sidomos në objektet banesore. Deri më tani, investimet në efijencë të energjisë janë përqendruar kryesisht në ndërtesa publike, ndonëse sektori i banimit përfaqëson pjesën më të madhe të konsumit fundor të energjisë. Për këtë arsye, për arritjen e caqeve e parapara për vitin 2031 do të lipset rritje e konsiderueshme e investimeve në rinovimin energjetik të objekteve banesore, krahas përpjekjeve për uljen e humbjeve në distribucion që vazhdojnë të jenë relativisht të larta.²⁸ Njëkohësisht, zgjerimi i masave për rritje të efijencës së energjisë mund të sjellë përfitime të rëndësishme ekonomike, përfshirë krijimin e mijëra vendeve të reja të punës, uljen e konsumit të energjisë dhe forcimin e sigurisë energjetike.²⁹

Objektiv tjetër i strategjisë është zhvillimi i sistemeve të akumulimit, në kuadër të të cilit parashihet ndërtimi i sistemeve të akumulimit të rezervës përmes baterive me kapacitet prej 340 MWh. Projekti financohet nga Millennium Challenge Corporation (MCC) dhe aktualisht ndodhet në fazën administrative. MCC dhe Ministria e Ekonomisë kanë bërë përparim në procedurat e prokurimit, bartjes së tokës dhe përgatitjes së lokacionit për instalimin e baterive, si dhe kanë themeluar ndërmarrjen publike "Korporata e Ruajtjes së Energjisë".³⁰ Sa i përket zgjerimit të ngrohjes qendrore përmes kogjenerimit, kapaciteti aktual prej 140 MWth dëshmon përmbushjen e caktuar për periudhën 2024/2025. Megjithatë, projekti i ri për dyfishimin e këtij kapaciteti nuk ka filluar ende.³¹ Një tjetër objektiv i përcaktuar me strategji është vënia në zbatim e një sistemi për tarifimin e emetimeve të karbonit, me qëllim uljen e emetimeve, adresimin

²⁴ Ministria e Ekonomisë. [Njoftim për kontratë. Proces konkurrues i tenderimit/i brendshëm nr.:01-001-2023.](#)

²⁵ Parlamenti Evropian. [Pasqyrë e përhapjes së marrëveshjeve për blerje të energjisë dhe kontratave për diferencë në shtetet anëtare.](#) 2026.

²⁶ Radio Evropa e Lirë. [Asnjë panel në fushë: Cfarë po ndodh me parkun diellor millionësh në Rahovec?](#) 2026.

²⁷ Burimi i Ripërtërishëm i Energjisë në Kosovë (RESKosovo). [Ankandi i erës 100 MW.](#) 2025

²⁸ Të dhëna të dërguara nga Fondi i Kosovës për Efijencë të Energjisë dhe Ministria e Ekonomisë.

²⁹ GAP Institute. [Governments' support to improving energy efficiency as a response to mitigating \(future\) energy shocks Western Balkan 6.](#) 2024.

³⁰ Millennium Challenge Corporation (MCC). [Përvjetori i dytë i hyrjes në fuqi të Programit të MCC Kosovo Compact.](#) 2026.

³¹ Të dhëna të siguruar nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

paraprak të detyrimeve që lidhen me CBAM-in dhe krijimin e një Fondi për Tranzicion të Drejtë, i cili do t'i mbante të hyrat në vend. Megjithatë, deri më tani nuk është ndërmarrë asnjë hap drejt këtij përbushjes së kësaj objektivë.³²

Dokument tjetër kombëtar që përcakton caqet të matshme dhe masa politike për përbushjen e zotimeve energjetike dhe klimatike deri në vitin 2030 është Draft Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë (PKEK) 2025–2030.³³ Ky plan ngërthen pesë dimensione kryesore: dekarbonizimi, eficientia e energjisë, siguria energjetike, tregu i brendshëm i energjisë, si dhe hulumtimi, inovacioni dhe konkurrueshmëria. Dokumenti shërben si udhërrëfyes për Kosovën në arritjen e caqeve klimatike dhe energjetike të miratuara nga Këshilli i Ministrorëve të Komunitetit të Energjisë³⁴ në vitin 2022. Në veçanti, dokumenti vë theksin te ulja e emetimeve të gazrave serrë, zhvillimi i kapaciteteve të burimeve të ripërtëritshme, përmirësimi i eficientisë së energjisë dhe forcimi i sigurisë energjetike. Po ashtu, ai nënvizon nevojën për t'i adresuar emetimet edhe në sektorë të tjerë veç atij të prodhimit të energjisë elektrike, si transporti, ngrohja dhe industria. Dimensionet e përcaktuara në këtë dokument bazohen në dimensionet e Unionit të Energjisë, ndërsa objektivat dhe masat e përcaktuara në Strategjinë për energji të Kosovës janë përfshirë në të. Krahasuar me strategjinë, PKEK përmban një gamë më të gjerë dimensionesh dhe mbulon një periudhë pesëvjeçare.³⁵

Tabela 2. Draft Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë 2025–2030 – caqet kryesore të tranzicionit energjetik dhe dekarbonizimit

Nëndimensioni	Caku (2030)
Emetimet e gazrave serrë	Ulja e emetimeve të gazrave serrë me 16.3% deri në vitin 2030, që është e barasvlershme me rreth 8.95 milionë tonë CO ₂
Energjia e ripërtëritshme	Energjia e ripërtëritshme të përbëjë 32% të konsumit final bruto të energjisë deri në vitin 2030 Kapaciteti i energjisë së ripërtëritshme të arrijë rreth 1,400 MW deri në vitin 2030
Eficientia e energjisë	Kufizimi i konsumit final të energjisë në 1.8 Mtoe deri në vitin 2030
Spektori i ngrohjes	Zgjerimi i ngrohjes qendrore përmes projekteve të energjisë së ripërtëritshme, si Solar4Kosovo

Burimi: Qeveria e Kosovës, Platforma për Konsultime Publike.

Përveç dy dokumenteve kombëtare të sipërpërmendura, Kosova po ashtu është bërë pjesë e Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor përmes miratimit të Deklaratës së Sofjes në vitin 2020.³⁶ Agjenda e Gjellbër krijon një kornizë rajonale që synon t'u mundësojë shteteve të Ballkanit Perëndimor ndërtimin e një ekonomie me neutralitet klimatik, eficiente në përdorim të burimeve dhe konkurruese, si dhe të mbështesë integrimin e rajonit në kornizën e politikave klimatike dhe energjetike të Bashkimit Evropian. Agjenda ka pesë shtylla kryesore: masat për reduktimin e ndryshimeve klimatike (përfshirë dekarbonizimin, energjinë dhe mobilitetin), ekonominë qarkore (veçanërisht menaxhimin e mbeturinave, riciklimin, prodhimin e qëndrueshëm dhe përdorimin efiçient të burimeve), biodiversitetin (mbrojtjen dhe restaurimin e pasurive natyrore të rajonit), luftimin e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës, si dhe sistemet ushqimore dhe zona rurale të qëndrueshme.³⁷ Si palë nënshkruese e kësaj agjende, Kosova është zotuar të përbushë një sërë objektivash dhe zotimesh të përcaktuara (Tabela 3).

³² Të dhëna të siguruar nga intervistat me Ministrinë e Ekonomisë.

³³ Qeveria e Kosovës. [Projektplan kombëtar për energji dhe klimë për Republikën e Kosovës 2025–2030](#)

³⁴ Komuniteti i Energjisë. [Vendim i Këshillit Ministror nr. 2021/14/8MC të KE, 2022.](#)

³⁵ Qeveria e Kosovës. [Projektplan kombëtar për energji dhe klimë për Republikën e Kosovës 2025–2030.](#)

³⁶ Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (KBR). [Deklarata e Sofjes për Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor.](#)

³⁷ Komisioni Evropian. [Udhëzime për zbatimin e Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor.](#) 2020.

Tabela 3. Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor – zotimet kryesore për tranzicionin energjetik dhe dekarbonizimin.

Shtylla	Zotimet dhe caqet kryesore
Masat për reduktimin e ndryshimeve klimatike, energjia dhe mobiliteti	Harmonizimi me Legjislacionin e BE-së për klimën dhe kontributi në përmbushjen e objektivit për neutralitet klimatik deri në vitin 2050 Hartimi dhe zbatimi i Planit kombëtar për energji dhe klimë (PKEK) Ulja e emetimeve të gazrave serrë dhe dekarbonizimi i sektorit të energjisë Rritja e pjesës së energjisë së ripërtëritshme në konsumin e energjisë dhe përmirësimi i eficiencës së energjisë në të gjithë sektorët. Krijimi i mekanizmave për tarifimin e emetimeve të karbonit dhe përafrimi gradual me Sistemin e tregtimit të emetimeve të BE-së (EU ETS) Heqja graduale e subvencioneve për thëngjillin dhe mbështetja e tranzicionit të drejtë
Ekonomia qarkore	Rritja e eficiencës në përdorimin e burimeve dhe ulja e gjenerimit të mbeturinave Promovimi i riciklimit, ripërdorimit dhe rikuperimit të materialeve Mbështetja e modeleve të qëndrueshme të prodhimit dhe konsumit Zhvillimi i modeleve qarkore të biznesit dhe industrive të gjelbra
Ulja e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës	Ulja e ndotjes së ajrit nga industria, prodhimi i energjisë dhe transporti

Burimi: Komisioni Evropian dhe Këshilli për Bashkëpunim Rajonal.

Kosova ka bërë disa hapa përpara në përmbushjen e zotimeve të saj në kuadër të Agjendës së Gjelbër. Më konkretisht, ajo ka përgatitur Draft Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën, që nuk është miratuar akoma, ka miratuar Ligjin për ndryshimet klimatike, ka zgjeruar programet për eficiencë të energjisë dhe ka realizuar ankande për burime të ripërtëritshme, me qëllim rritjen e përqindjes së pjesëmarrjes së energjisë nga burimet e ripërtëritshme në strukturën e prodhimit të energjisë. Megjithatë, siç evidentohet në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2025³⁸, ritmi i zhvillimit të kapaciteteve nga burimet e ripërtëritshme duhet të përshpejtohet për të mundësuar arritjen e caqeve të përcaktuara. Më konkretisht, në Kapitullin 15 për energjinë, Komisioni Evropian rekomandon që Kosova ta miratojë Draft Planin Kombëtar për Energji dhe Klimë, që është akoma në version drafti, si dhe pakon e ligjeve për energjinë që synojnë harmonizimin me Pakon për integrimin e energjisë elektrike dhe Pakon për energji të pastër. Më tej, raporti rekomandon që modernizimi i termocentralit Kosova B dhe dekomisionimi i pjesëve jofunksionale të termocentralit Kosova A të përshpejtohen. Vendi duhet po ashtu të punojë për funksionalizimin e sistemit të garancive të origjinës (GO), përmes miratimit të rregullave për publikimin e informacionit dhe metodologjive për llogaritjen e miksit rezidual. Sa i përket eficiencës së energjisë, raporti për Kosovën evidenton boshllëqe ligjore dhe institucionale, përfshirë nevojën për miratimin e Ligjit të ri për eficiencën e energjisë dhe të legjislacionit dytësor të nevojshëm për zbatimin e Ligjit për performancën energjetike të ndërtesave. Krahas këtyre gjetjeve, raporti vë në dukje nevojën për burime shtesë financiare, kapacitete më të forta institucionale për zbatim dhe monitorim, si dhe përafrim më të madh me legjislacionin e BE-së për etiketim energjetik dhe ekodizajn.³⁹ Sa i përket Kapitullit 27 për mjedisin dhe ndryshimet klimatike, Kosova ka shënuar progres të kufizuar. Disa hapa janë ndërmarrë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), e cila ka përmirësuar në masë të kufizuar kapacitetet administrative dhe ka miratuar Strategjinë e integruar për menaxhimin e mbeturinave dhe planin e veprimit 2024–2026. Megjithatë, raporti i Komisionit rekomandon që Kosova të ndërmarrë masa të përshtatshme për zonat e mbrojtura dhe të mos lejojë ndotjen e tyre, të ndryshojë Ligjin për menaxhimin e mbeturinave dhe të zbatojë Ligjin për ndryshimet klimatike.⁴⁰

38 Komisioni Evropian, [Raporti për Kosovën* 2025](#), 2025

39 Po aty.

40 Po aty.

Deri më tani, zhvillimi i kapaciteteve nga burimet e ripërtëritshme në Kosovë ka ecur me ritëm të ngadaltë, siç dëshmohet nga rritja graduale e kapacitetit neto të instaluar nga 116 MW në vitin 2018 në 301 MW në vitin 2025. Megjithatë, ka një sërë projektsh të mëdha që janë në proces. Disa prej tyre kanë marrë tashmë licencat e nevojshme nga Zyra e Rregullatorit për Energji dhe janë në fazën e ndërtimit, ndërsa të tjerat pritet të realizohen përmes ankandeve të organizuara nga Ministria e Ekonomisë. Në total, janë paraparë rreth 700 MW investime të reja në energjinë diellore dhe atë të erës. Me hyrjen në operim, këto projekte pritet të kenë rol të rëndësishëm në përmirësimin e sigurisë energjetike, uljen e intensitetit të emetimeve të karbonit dhe mbështetjen e zotimeve të Kosovës në kuadër të Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor dhe kornizës së Komunitetit të Energjisë. Megjithatë, zbatimi i disa prej këtyre projekteve është përcjellë me vonesa të vazhdueshme, duke zgjatur afatet e zbatimit sesa që ishte paraparë fillimisht. Që nga fillimi i fazës administrative, këto projekte kanë pësuar vonesa të përsëritura, gjë që ka zgjatur afatin e hyrjes në operim.

Tabela 4. Disa projekte të reja të BRE të planifikuara/në ndërtim e sipër në Kosovë

Projekti	Lloji i energjisë	Kapaciteti i instaluar	Zbatimi
Parku i erës në Zatriq	E erës	70 MW	I përfunduar (hyrja në funksion pritet në korrik 2026)
Projekti "SEGE"	Solare	150 MW	Në ndërtim e sipër
Lindja Solar (ankand)	Solare	100 MW	Faza administrative
Ankandi për energji të erës	E erës	100 MW	Faza administrative
Parku solar (KEK)	Solare	100 MW	Faza fillestare
Projekti i paneleve solare në Istog	Solare	150 MW	Faza fillestare
Projekti i paneleve solare në Junik	Solare	100 MW	Faza fillestare

Burimi: ZRRE, KEK, BERZH

1.3. Sfidat në zhvillimin e kapaciteteve nga burime të ripërtëritshme të energjisë dhe nevoja për One-Stop Shops (OSS)

Pavarësisht zhvillimeve pozitive, zbatimi i projekteve të energjisë së ripërtëritshme vazhdon të shoqërohet me sfida. Një sërë projektsh ndodhen akoma në fazë administrative ose në fazë të hershme zhvillimi, ndërkohë që vështirësitë administrative dhe institucionale po vonojnë zbatimin e tyre. Sipas Ministrisë së Ekonomisë, ndër faktorët kryesorë që shkaktojnë vonesat janë procedurat e gjata të pajisjes me leje dhe licenca, kapacitetet e kufizuara të rrjetit, çështjet pronësore dhe pengesa tjera administrative.⁴¹ Kufizimet administrative dhe institucionale janë identifikuar si sfida edhe në një raport të OECD-së⁴², ku theksohet se procedurat janë të ndërlikuara, kërkojnë përfshirjen e disa institucioneve dhe, për këtë arsye, marrin shumë kohë. Vlerësohet se në Kosovë i gjithë procesi, duke filluar nga autorizimi paraprak e deri te kyçja në rrjet, mund të zgjasë deri në tre vjet.⁴³ Është evidentuar mungesë e procedurave të standardizuara dhe mbivendosje e përgjegjësive institucionale, që e bëjnë procesin e pajisjes me leje kompleks. Pengesat procedurale mund të shfaqen edhe për shkak të numrit të kufizuar të personelit dhe trajnimit teknik joadekuat. Në të njëjtën kohë, mospërcaktimi i zonave të dedikuara për investime në zhvillim të kapaciteteve nga burime të ripërtëritshme të energjisë mund ta vonojë iniciimin e projekteve.⁴⁴ Sfidë për projektet e energjisë nga burime të ripërtëritshme përbëjnë po

41 Informata të siguruara nga intervistat me Ministrinë e Ekonomisë.

42 OECD. *Shqyrtim shumëdimensional i Ballkanit Perëndimor. Nga analiza në veprim*. 2022.

43 Po aty

44 Panagiotakis, I. dhe të tjerë. *Përdorimi i kornizës së BE-së për pajisjen me leje mjedisore për të nxitur tranzicionin energjetik në Ballkanin Perëndimor – Rasti i Kosovës*. 2025

ashtu edhe kapacitetet e kufizuara të rrjetit, pasi shpesh krijohen kufizime kapaciteti që e pengojnë absorbimin e sasive shtesë të energjisë së prodhuar nga burime të ripërtëritshme.⁴⁵ Ngjashëm, Komuniteti i Energjisë identifikon një sërë vështirësish në proceset e pajisjes me leje për investimet në energji të ripërtëritshme në Evropë, duke filluar nga procedurat e gjata dhe komplekse, në të cilat marrin pjesë disa institucione (energji, mjedis, rregullatorë, ndërtim dhe operatorë rrjeti), e që në disa shtete mund të zgjasin 3–10 vjet për investimet në energjinë e erës dhe 2–6 vjet për investimet në energjinë diellore. Problem tjetër është paparashikueshmëria e epilogut të të gjitha procedurave, që mund të shkaktohet mes tjerash edhe nga procedurat për lidhje në rrjet që në disa shtete mund të zgjasin deri në 7 vjet. Operatorët e rrjetit shpesh veprojnë në mënyrë të pavarur dhe kanë kompetenca ekskluzive, gjë që bën që procedurat e tyre të mos jenë të integruara me procesin e pajisjes me leje. Si kufizim evidentohet edhe digjitalizimi, meqë shumë hapa të procesit të pajisjes me leje janë joefikasë dhe akoma nuk janë digjitalizuar plotësisht.⁴⁶

Vështirësitë e sipërpërmendura, si vonesat dhe pengesat procedurale që burojnë nga mungesa e koordinimit ndërmjet institucioneve dhe paqartësitë në ndarjen e përgjegjësiave, vënë në dukje nevojën për reforma më proaktive për thjeshtimin e proceseve të licencimit, uljen e burokracisë dhe përmirësimin e stimujve për investitorët në projekte të energjisë nga burime të ripërtëritshme. Këto vështirësi sjellin në pah nevojën për krijimin e pikave të vetme të shërbimeve që do t'u ofronin aplikuesve udhëzime dhe do t'ua lehtësonin procesin e pajisjes me leje. Këto pika, të njohura si One-Stop Shops (OSS, shqip: pika të vetme shërbimesh), shërbejnë si platformë e centralizuar ndërmjet investitorëve dhe autoriteteve publike që koordinon të gjitha procedurat administrative dhe ua lehtëson aplikuesve procesin, duke shmangur nevojën për t'iu drejtuar veçmas institucioneve të shumta. Përveç ofrimit të udhëzimeve rreth kriterëve të pajisjes me leje, vlerësimeve mjedisore dhe procedurave të kyçjes në rrjet, OSS-të monitorojnë ecurinë e aplikimeve, lehtësojnë koordinimin ndërmjet institucioneve dhe përdorin platforma digjitale për dorëzimin, përcjelljen dhe menaxhimin e lejeve. Kjo rrit transparencën, llogaridhënien dhe efikasitetin e procedurave të pajisjes me leje.⁴⁷ Komisioni Evropian ka rishikuar Direktivën për energji të ripërtëritshme (RED), e cila tani kërkon nga shtetet anëtare që t'i krijojnë këto pika kontakti për t'i udhëzuar aplikuesit gjatë proceseve të pajisjes me leje dhe për të siguruar respektimin e afateve. Direktiva e rishikuar parasheh po ashtu një sërë reformash që synojnë adresimin e mëtejshëm të vështirësive në realizimin e projekteve të energjisë nga burime të ripërtëritshme (Tabela 5).⁴⁸

Tabela 5. Ndryshimet kryesore sipas Direktivës së rishikuar të BE-së për energji të ripërtëritshme

Ndryshimet kryesore sipas Direktivës së rishikuar RED	Përshkrimi
Zgjerimi i fushëveprimit të procedurave të pajisjes me leje	Korniza e pajisjes me leje tani mbulon impiantet e energjisë së ripërtëritshme, projektet hibride, pompat termike, sistemet e akumulimit të energjisë të vendosura pranë kapaciteteve prodhuese, infrastrukturën përcjellëse të rrjetit, lejet për lidhje në rrjet dhe vlerësimet mjedisore.
Përcaktimi i qartë i afateve të procedurave të pajisjes me leje	Procesi i pajisjes me leje fillon zyrtarisht pasi të konfirmohet pranimi i një aplikimi të plotë dhe përfundon me njoftimin e vendimit përfundimtar.
Digjitalizimi i detyrueshëm	Deri në nëntor 2025, të gjitha procedurat për dhënien e lejeve duhet të zhvillohen në mënyrë elektronike.

45 REGlobal. [Tranzicioni energjetik në Kosovë, Serbi, Maqedoni të Veriut](#). 2025.

46 Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. [Reforma e pajisjes me leje dhe energjia e ripërtëritshme](#). 2026

47 Po aty.

48 Po aty.

Fuqizimi i One-Stop Shops (OSS)	Pikat e vetme të kontaktit duhet t'i udhëzojnë aplikuesit në të gjitha fazat e procesit të pajisjes me leje, përfshirë procedurat mjedisore, dhe të sigurojnë respektimin e afateve ligjore.
Mekanizma për zgjidhjen më të shpejtë të kontesteve	Aplikuesit dhe publiku duhet të kenë qasje në procedura të thjeshtuara për zgjidhjen e kontesteve, përfshirë mekanizmat alternativë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.
Zonat e përcaktuara për përshpejtimin e zhvillimit të kapaciteteve nga burime të ripërtëritshme (RAA)	Zona të përcaktuara si të përshtatshme për zhvillimin e projekteve të energjisë nga burime të ripërtëritshme dhe me ndikim të kufizuar mjedisor, ku zbatohen procedura të thjeshtuara dhe afate më të shkurtra për pajisjen me leje.
Thjeshtimi i vlerësimeve mjedisore	Vlerësimet mjedisore duhet të koordinohen ose, kur është e mundur, të integrohen në një procedurë të vetme.

Burimi: Komuniteti i Energjisë

Bazuar në Direktivën e rishikuar, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka paraqitur tri modele opsionale të One-Stop Shops për energji të ripërtëritshme (OSS RE), varësisht nga fushëveprimi i përgjegjësive të tyre. Modeli më bazik është OSS për informim dhe udhëzim, që vepron kryesisht si qendër informacioni, duke u ofruar investitorëve udhëzime të plota për kriteret e pajisjes me leje dhe procedurat e realizimit të projekteve. Megjithatë ky model rrit transparencën dhe qasjen në informacion, ai nuk e bashkërendon në mënyrë aktive procesin e pajisjes me leje. Model më i avancuar është OSS koordinuese, që është në përputhje të plotë me Direktivën, meqë shërben si pikë e vetme kontakti për investitorët dhe njëherazi koordinon ndërveprimet ndërmjet të gjitha autoriteteve kompetente. Ndërkohë që vendimet për pajisjen me leje mbeten përgjegjësi e institucioneve përkatëse, OSS mbikëqyr procesin, monitoron afatet dhe lehtëson komunikimin për të siguruar vendimmarrje në kohë. Modeli më gjithëpërfshirës është OSS me përgjegjësinë për dhënien e lejeve. Sipas kësaj qasjeje, procedura të shumta të pajisjes me leje integrohen në një kornizë të vetme, duke i mundësuar OSS të nxjerrë një vendim të konsoliduar që mbulon të gjitha miratimet dhe vlerësimet përkatëse. Ky model shkon përtej kërkesave minimale të Direktivës së rishikuar, pasi ul ndjeshëm barrën administrative dhe krijon një proces shumë më të thjeshtuar për investitorët.⁴⁹

Procesi i pajisjes me leje në Kosovë ngërthen një sërë procedurash dhe institucioneve, secila syresh me përgjegjësi të ndryshme. Përmes Rregullores nr. 05/2018⁵⁰, Kosova ka krijuar një One-Stop Shop⁵¹ për burimet e ripërtëritshme të energjisë në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, me qëllim koordinimin, bashkëpunimin dhe informimin e palëve gjatë procesit të investimeve në burime të ripërtëritshme të energjisë. Ajo funksionon kryesisht si mekanizëm koordinimi dhe informimi përmes një Komisioni Koordinues Ndërinstitucional, që bashkon të gjitha institucionet përkatëse të përfshira në procesin e pajisjes me leje⁵² (Tabela 6).

Tabela 6. Përgjegjësitë institucionale në kuadër të Komisionit Koordinues Ndërinstitucional të OSS

Institucioni	Përgjegjësitë kryesore në procesin e pajisjes me leje
Ministria e Ekonomisë	Udhëheq OSS dhe Komisionin Koordinues Ndërinstitucional; përgjegjëse për politikat energjetike dhe caqet për energjinë e ripërtëritshme.
Zyra e Rregullatorit për Energji	Lëshon autorizimet për ndërtim dhe licencat për prodhim; administron skemat mbështetëse, certifikatat e origjinës dhe marrëveshjet për blerjen e energjisë.
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	Lëshon pëlqimet mjedisore, lejet ujore dhe lejet ndërtimore për projektet mbi 10 MW; shqyrton vlerësimet e ndikimit në mjedis (VNM).

49 Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. [Reforma e pajisjes me leje dhe energjia e ripërtëritshme](#). 2026

50 Ministria e Ekonomisë. [Rregullorja nr.05/2018 për one stop shop për burimet e ripërtëritshme të energjisë](#). 2022.

51 [Portali i burimeve të ripërtëritshme të energjisë të Kosovës](#). 2026

52 Ministria e Ekonomisë. [Raport për Doracakun operacional për one stop shop](#). 2022

Institucioni	Përgjegjësitë kryesore në procesin e pajisjes me leje
Komunat	Përgjegjëse për miratimin e planeve zhvillimore komunale dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor që identifikojnë zonat e përshtatshme për ndërtimin e centraleve energjetike. Gjithashtu lëshojnë leje ndërtimore për projektet e energjisë së ripërtëritshme nën 10 MW dhe leje mjedisore për projektet që nuk kërkojnë vlerësim të ndikimit në mjedis (VNM).
KOSTT	Siguron qasje në rrjetin e transmisionit dhe përcakton kushtet e lidhjes për projektet e energjisë së ripërtëritshme.
KEDS	Siguron lidhjen me rrjetin e shpërndarjes dhe vlerësimet e kostove të lidhjes në rrjet.
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	Jep të drejta për shfrytëzimin e tokave pyjore.
Ministria e Financave	Përgjegjëse për politikat fiskale, doganat, tatimet dhe stimujt fiskalë që lidhen me energjinë e ripërtëritshme.
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	Mbështet bizneset, regjistrimin e tyre dhe promovimin e investimeve.
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	Rregullon procedurat për dhënien në shfrytëzim të tokës komunale dhe mbikëqyr zbatimin e legjislacionit nga komunat.

Burimi: Ministria e Ekonomisë

Më konkretisht, mandati i OSS në Kosovë përfshin ofrimin e informatave dhe udhëzimeve për investitorët lidhur me kërkesat ligjore, administrative dhe procedurale; monitorimin e zhvillimit dhe mbarëvajtjes së investimeve në burime të energjisë së ripërtëritshme; komunikimin e rregullt me investitorët, Zyrën e Rregullatorit për Energji dhe institucionet e tjera të përfshira në procedurat e pajisjes me leje; si dhe koordinimin me autoritetet përgjegjëse me qëllim të harmonizimit të informacionit dhe lehtësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional me qëllim thjeshtimin e procedurave administrative, përcjelljen e statusit të aplikimeve për leje; ofrimin e ndihmës në adresimin e vonësive apo pengesave procedurale përmes konsultimeve dhe angazhimit me autoritetet përkatëse. Veç kësaj, ajo mbledh dhe trajton rekomandimet e palëve të interesit, propozon përmirësime ligjore dhe procedurale kur është e nevojshme, si dhe harton udhëzues informues për t'i orientuar investitorët dhe për ta përmirësuar koordinimin dhe respektimin e legjislacionit në fuqi.⁵³ Megjithatë, duhet theksuar se modeli aktual i PVSH-së në Kosovë funksionon kryesisht si mekanizëm informimi dhe koordinimi institucional dhe se, deri më tani, nuk ka arritur të tregojë rezultate konkrete në bashkërendim apo në zvogëlim të barrës administrative në procesin e pajisjes me leje. Për më tepër, ai nuk ka kompetenca për t'u imponuar institucioneve respektimin e afateve, për të marrë vendime apo për të lëshuar leje.

⁵³ Ministria e Ekonomisë. [Raport për Doracakun operacional për one stop shop](#). 2022

2. Mekanizmi i rregullimit të kufirit për karbon (CBAM) dhe ekspozimi tregtar

2.1. Zbatimi i mekanizmit CBAM

Mekanizmi CBAM u bë plotësisht funksional më 1 janar 2026, pas një periudhe kalimtare që zgjati nga tetori 2023 deri në dhjetor 2025. Si pjesë e paketës "Fit for 55" të BE-së,⁵⁴ CBAM paraqet politikën e parë plotësisht funksionale në botë për rregullim të kufirit për emetim të karbonit, që synon të caktojë një çmim të drejtë për emetimet e karbonit të inkuorporuara në mallrat e importuara në BE dhe të parandalojë të ashtuquajturën "rrjedhje të karbonit". Fillimisht, mekanizmi mbulon importet e hekurit dhe çelikut, aluminit, çimentos, plehrave, energjisë elektrike dhe hidrogjenit, dhe zbatohet ndaj eksportuesve jashtë BE-së, me përjashtime të kufizuara për shtete ku tarifimi i emetimeve të karbonit është i harmonizuar me Sistemin e tregtimit të emetimeve të BE-së (EU ETS).⁵⁵

Në terma praktikë, importuesit e këtyre mallrave duhet të regjistrohen si deklarues të autorizuar të CBAM-it dhe të pajisen me një numër llogarie CBAM për t'i vendosur mallrat në qarkullim të lirë në BE.⁵⁶ Deklarimi i parë vjetor në kuadër të CBAM dhe dorëzimi i certifikatave duhet të bëhen deri më 30 shtator 2027, për mallrat e importuara gjatë vitit 2026, ndërsa çmimi i certifikatave do të bazohet në çmimin mesatar tremujor sipas EU ETS për atë vit.⁵⁷ Sipas Komisionit Evropian, çmimi sipas CBAM për mallra me intensitet të lartë emetimi të karbonit të importuara në BE gjatë tremujorit të parë të vitit 2026 ishte caktuar në vlerën prej 75.36 euro për tCO₂eq.⁵⁸ Deklarata duhet po ashtu të përfshijë: 1) sasinë totale të importuar, të shprehur në megavat-orë për energjinë elektrike dhe në ton për mallrat e tjera; dhe 2) emetimet totale të inkuorporuara, të shprehura në ton ekuivalent të CO₂ (CO₂e) për megavat/orë për energjinë elektrike ose për ton produkti për mallrat e tjera, kur përdoren të dhëna reale për emetimet.⁵⁹

Ndërkohë, në shkurt të vitit 2025, Parlamenti Evropian miratoi disa ndryshime në CBAM në kuadër të pakos së thjeshtësimit Omnibus I.⁶⁰ Si rezultat, u vendos një prag i ri de minimis, sipas të cilit "importet deri në 50 tonë në vit për importues nuk do t'u nënshtrohen rregullave të CBAM-it",⁶¹ me përjashtim të importeve të energjisë elektrike dhe hidrogjenit.⁶² Këto ndryshime u miratuan për ta ulur barrën administrative, ruajtur konkurrueshmërinë dhe mbështetur rritjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që aktualisht ndodhen nën këtë prag.⁶³ Deklaruesit janë

54 Paketa "Fit for 55" përbën një grup masash legjislativë që synojnë uljen e emetimeve të gazrave serrë në Bashkimin Evropian për të paktën 55% deri në vitin 2030 dhe mbështetjen e synimit të BE-së për arritjen e neutralitetit klimatik deri në vitin 2050. Këshilli Evropian. [Fit for 55](#).

55 Në këtë rast, shtetet e lira nga zbatimi i CBAM-it janë Norvegjia, Islanda, Lihtenshtajni dhe Zvicra, sepse i kanë harmonizuar sistemet e tyre të tregtimit të emetimeve me Sistemin e Tregtimit të Emetimeve të Bashkimit Evropian (EU ETS). Komisioni Evropian. [Fushëveprimi i EU ETS](#).

56 Komisioni Evropian. [Regjistrimi dhe raportimi sipas CBAM](#).

57 Bashkimi Evropian. Neni 22. Dorëzimi i certifikatave CBAM. [EUR-Lex. Qasja në legjislacionin e Bashkimit Evropian](#).

58 75.36 euro për ton ekuivalent të dioksidit të karbonit. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Raport tremujor për CBAM-in, 2026/1.

59 Po aty. Neni 6 mbi Deklaratën CBAM dhe neni 35 mbi detyrimin për raportim.

60 Pakoja Omnibus I përbën një grup masash të Bashkimit Evropian që synojnë uljen e barrës rregullatore dhe forcimin e konkurrueshmërisë, duke e ruajtur njëherësh objektivat ekonomike, sociale dhe mjedisore. Komisioni Evropian. [Pakaja omnibus](#).

61 Parlamenti Evropian. [CBAM: Parlamenti miraton thjeshtësime të instrumentit të BE-së për parandalimin e rrjedhjes së karbonit](#). 2025

62 Po aty.

63 Logaritjet nga periudha kalimtare 2023-2025 tregojnë se në mesin e këtyre NVM-ve përfshihen rreth 180 mijë ndërmarrje. Megjithatë përjashtohen nga detyrimet e CBAM-it, mekanizmi vazhdon të mbulojë rreth 99% të emetimeve përmes importuesve të mëdhenj, që përbëjnë vetëm rreth 10% të numrit të përgjithshëm të importuesve, por gjenerojnë pjesën dërrmuese të rrezikut të rrjedhjes së karbonit. Kjo qasje synon të ulë barrën administrative për bizneset e vogla, duke përqendruar detyrimet e plota të pajtueshmërisë të emetuesit kryesorë. Po aty.

po ashtu të obliguar të evidentojnë numrin total të certifikatave CBAM që duhet të dorëzojnë, pasi të jenë marrë parasysh çdo tarifë për emetimet e karbonit e paguar tashmë në një shtet të tretë dhe përshtatjet që lidhen me alokimin falas të kuotave në kuadër të EU ETS.⁶⁴

Tabela 7. Afati kohor për zbatimin e CBAM

Tetor 2023 – dhjetor 2025	Shkurt 2025	Janar 2026	Shkurt 2027	Shtator 2027	Deri 2034
Faza kalimtare	Reforma omnibus	Fillimi i fazës përfundimtare	Hapja e tregut të certifikatave	Shlyerja e parë e detyrimeve financiare	Regjim i plotë
Kërkohej raportim tremujor i emetimeve. Nuk zbatohen ende detyrime financiare.	Përjashtimi de minimis prej 50 tonësh në vit për importues.	CBAM hyn plotësisht në fuqi. Importuesit duhet të regjistrohen si deklarues të autorizuar CBAM.	Të gjitha certifikatat CBAM do të blihen përmes platformës së përbashkët qendrore.	Deklarimi dhe dorëzimi i certifikatave	Kalim gradual drejt harmonizimit të plotë.

Burimi: Komisioni Evropian

2.2. Ekspozimi sektorial ndaj CBAM-it

Kosova është në mesin e vendeve të treta eksportuesit e të cilave preken drejtpërdrejt nga rregullorja për CBAM-in. Pra, eksportuesit kosovarë të hekurit dhe çelikut, aluminit, energjisë elektrike, çimentos dhe plehrave u nënshtrohen detyrimeve të reja për pajtueshmëri në kuadër të këtij mekanizmi. Ndonëse eksportet e Kosovës për të cilat zbatohet CBAM përbëjnë një pjesë relativisht të vogël të eksporteve të përgjithshme drejt BE-së, rëndësia e mekanizmit nuk qëndron te vëllimi tregtar, por te detyrimet për pajtueshmëri dhe tarifën për emetimet e karbonit që ai vendos për eksportuesit kosovarë që operojnë në këta sektorë.

Gjatë vitit 2025, vlera e përgjithshme e eksporteve të Kosovës drejt BE-së arriti në rreth 316 milionë euro. Nga kjo shumë, rreth 12% përbëhej nga mallra me intensitet të lartë emetimi të karbonit që hyjnë në fushëveprimin e CBAM-it, me vlerë afërsisht 37.6 milionë euro.⁶⁵ Sektori i hekurit dhe çelikut pritet të jetë më i prekuri nga CBAM, me rreth 72% të të gjitha eksporteve të Kosovës drejt BE-së për të cilat zbatohet CBAM, pasuar nga alumini, që përfaqëson rreth 27% të vlerës totale të eksporteve të prekura nga ky mekanizëm. Në krahasim me këta sektorë, eksportet e energjisë elektrike dhe çimentos vlerësohet se preken vetëm në shkallë marginale, ku secila përfaqëson rreth 1–2% të eksporteve të përgjithshme për të cilat zbatohet CBAM.⁶⁶ Po ashtu, ekspozimi i sektorit bankar ndaj CBAM-it mbetet i kufizuar, me rreth 2.5% të gjithsej kredive dhe 4.0% të kreditimit për korporata, që sugjeron nivel të ulët rreziku dhe nënkupton se CBAM nuk paraqet sfida për stabilitetin financiar vendor.⁶⁷

⁶⁴ Kur kërkohet, kompanitë duhet të dorëzojnë edhe raporte verifikimi të përgatitura nga verifikues të akredituar. Komisioni Evropian e administron sistemin përmes një Regjistri Qendror të CBAM-it, i cili është i ndërlidhur me sistemet kombëtare doganore të të gjitha shteteve të Bashkimit Evropian.

⁶⁵ Të dhënat e Doganës së Kosovës për eksportet vjetore për 2021-2025

⁶⁶ Hidrogjeni dhe plehrat kimike nuk janë përfshirë në analizë, pasi gjatë periudhës së raportimit nuk është regjistruar asnjë eksport i këtyre produkteve.

⁶⁷ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. [Raport mbi stabilitetin financiar](#). 2024. f.67.


Tabela 8. Eksportet e sektorëve me intensitet të lartë karboni drejt BE-së, sipas sektorit, si përqindje e vlerës totale të eksporteve të këtyre sektorëve në vitin 2025

Sektori i eksportit	Vlera në euro	Sektori i eksportit si % e eksporteve totale të sektorëve me intensitet të lartë karboni
Hekur dhe çelik	27,232,738.67	72.4%
Alumin	10,125,002.64	26.9%
Energji elektrike	249,566.92	0.7%
Çimento	1,315.58	0.003%

Burimi: Dogana e Kosovës

Gjatë periudhës 2021–2025, eksportet e Kosovës drejt BE-së ndaj të cilave zbatohet CBAM ishin të përqendruara kryesisht në dy sektorë: hekuri dhe çeliku, si dhe energjia elektrike.⁶⁸ Hekuri dhe çeliku mbetën kategoria më e madhe e eksporteve gjatë gjithë periudhës, ndonëse nivelet e eksportit ndryshuan ndjeshëm nga viti në vit. Eksportet e energjisë elektrike ishin shumë jostabile, me rritje të shpejtë në vitin 2022 në rreth 45 milionë euro, që u pasua nga një rënie e shpejtë dhe ra në nivele thuajse të papërfillshme deri në vitin 2025. Ndryshe nga këta sektorë, eksportet e aluminit ishin përgjithësisht stabile përgjatë viteve. Ndërkohë, çimentoja dhe plehrat kishin vëllime shumë më të kufizuara eksporti. Hidrogjeni nuk është përfshirë, pasi Kosova nuk eksporton hidrogjen.

Figura 3. Eksportet kosovare me intensitet të lartë karboni drejt BE-së, sipas sektorit, 2021–2025



Burimi: Dogana e Kosovës

Lidhur me këtë çështje, u zhvilluan disa intervista me eksportues kosovarë të produkteve që hyjnë në fushëveprimin e CBAM. Gjetjet kryesore janë si vijon:

- Niveli i ndërgjegjësimit dhe i përgatitjes lidhur me CBAM-in e BE-së rezultoi përgjithësisht i ulët në mesin e eksportuesve të intervistuar. Shumica e të intervistuarve raportuan se kanë njohuri të kufizuara ose nuk janë fare në dijeni për kriteret sipas CBAM-it, përfshirë për detyrimet për raportim dhe implikimet e mundshme financiare për eksportet drejt tregut të BE-së. Pavarësisht hyrjes në fuqi të mekanizmit, kompanitë e intervistuar deklaruan t'i kenë vazhduar eksportet në vëllime të ngjashme, kurse disa sosh deklaruan se ende nuk kanë marrë njoftime nga partnerët e tyre tregtarë në BE lidhur me kosto shtesë apo kërkesa të reja për pajtueshmëri që do të ndikonin në produktet e tyre.

⁶⁸ Të dhënat e Doganës së Kosovës për eksportet vjetore për 2021–2025.

- Të intervistuarit theksuan se qeveria dhe ministritë përkatëse nuk e kanë adresuar në mënyrë të mjaftueshme çështjen e CBAM-it, meqë nuk ka pasur shpërndarje të strukturuar të informacionit, trajnime apo komunikime zyrtare në formën e e-mailave apo materialeve udhëzuese. Kjo mungesë informacioni ka kontribuar ndjeshëm në nivelin e ulët të ndërgjegjësimit, duke rezultuar që shumë kompani të jenë të shqetësuara dhe të papërgatitura për sa i përket zbatimit të CBAM-it.
- Kompanitë kanë filluar të zgjerojnë përdorimin e energjisë diellore përmes instalimit të sistemeve fotovoltaike, të financuara kryesisht me kapital vetanak. Ky orientim është nxitur kryesisht nga liberalizimi i tregut të energjisë elektrike dhe rritja e çmimeve të energjisë, duke e bërë uljen e shpenzimeve motiv kryesor për investime në burime të ripërtëritshme të energjisë. Të intervistuarit theksuan mungesën e granteve apo skemave të dedikuara mbështetëse nga institucionet publike, çka ka bërë që kompanitë ta bartin vetë barrën financiare të këtyre investimeve. Sidoqoftë, shumica syresh vazhdojnë të mbështeten kryesisht në energjinë elektrike të prodhuar nga linjiti dhe të furnizuar nga KEK-u si burim dominues i energjisë.
- Edhe para hyrjes në fuqi të CBAM-it, kompanitë e sektorit privat përballëshin me sfida të shumta operationale dhe financiare, përfshirë kostot e larta të transaksioneve ndërkombëtare me shtetet e BE-së, tarifat e larta bankare për mirëmbajtje të llogarive, si dhe kufizime të ndryshme ligjore dhe institucionale që ndikojnë në veprimtarinë e tyre të përditshme afariste. Si rezultat, bizneset operojnë në një mjedis me kosto të larta, prandaj çdo barrë shtesë financiare që mund të rrjedhë nga CBAM-i pritet të rrisë më tej presionin mbi eksportuesit.
- Për kompanitë që duhet të përgatisin raporte në kuadër të CBAM-it, ky proces konsiderohet sfidues për shkak të nevojës për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave të detajuara mbi emetimet. Shumë kompani hasin vështirësi në grumbullimin dhe raportimin e saktë të këtyre të dhënave, sidomos ato që nuk kanë përvojë paraprake ose sisteme të zhvilluara për monitorimin e emetimeve. Kompanitë që operojnë në sektorin e hekurit dhe çelikut raportuan gjithashtu nevojën për burime njerëzore shtesë për përmbushjen e këtyre kërkesave, gjë që rrit kostot e pajtueshmërisë.
- Pavarësisht barrës financiare që CBAM mund të sjellë në vitet e ardhshme, shumica e kompanive që tashmë eksportojnë në BE deklaruan se nuk planifikojnë t'i ndërpresin eksportet, qëndrim ky i mbështetur në partneritetet afatgjata që kanë ndërtuar me klientët evropianë dhe në reputacionin e krijuar në treg. Për më tepër, duke pasur parasysh konkurrueshmërinë e lartë të eksporteve të Kosovës për nga çmimi, kompanitë shprehen se janë të bindura që partnerët e tyre në BE do të vazhdojnë bashkëpunimin përkundër kostove shtesë që mund të rrjedhin nga CBAM. Edhe nëse një pjesë e kësaj barre financiare do të transferohej te eksportuesit, ndërprerja e eksporteve nuk konsiderohet si opsion.

Rast studimi: Ndikimi i CBAM-it në EuroMetal, prodhues i metaleve në Kosovë

Profili i kompanisë: EuroMetal është një prodhues i produkteve metalike me seli në Kosovë, që operon prej rreth njëzet vjetësh. Aktualisht, kompania punëson rreth 80 punëtorë dhe rreth 90% të prodhimit të saj e eksporton në tregjet e Bashkimit Evropian, përfshirë Gjermaninë, Belgjikën, Italinë dhe Austrinë. Me kalimin e kohës, kompania ka arritur të pozicionohet në zinxhirët evropianë të furnizimit, ku konkurrueshmëria e çmimeve dhe besueshmëria janë faktorë kyç. Në këtë kuptim, zhvillimi i EuroMetal-it është ndërtuar mbi orientimin e saj drejt eksporteve dhe nevojën për t'iu përshtatur vazhdimisht kërkesave dhe presioneve të tregjeve ndërkombëtare.

Ndërgjegjësimi dhe angazhimi lidhur me CBAM-in: Kompania nuk mori vesh për Mekanizmin e rregullimit të kufirit për karbon (CBAM) të BE-së përmes institucioneve vendore, por përmes partnerëve të saj tregtarë në BE. Sipas menaxherit financiar të kompanisë, gjatë periudhës kalimtare klientët filluan të kërkonin raportime shtesë, gjë që e shtyu kompaninë të ndërmarrë hapat e parë për t'iu kuptuar dhe përmbushur kërkesat e CBAM-it. Pas këtij ekspozimi fillestar, EuroMetal filloi gradualisht t'iu integrojë praktikën e lidhura me CBAM-in në operacionet e saj. Tani, kompania i monitoron emetimet dhe raporton rregullisht të dhënat për emetimet e karbonit për qëllime eksporti, shpesh në baza tremujore, varësisht nga kërkesat e klientëve. Kompania ka marrë pjesë gjithashtu në një trajnim për CBAM-in të organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës. Megjithatë, i intervistuari theksoi se ky nivel përgatitjeje nuk është i përhapur në tërë sektorin, meqë sipas tij shumë prodhues në Kosovë janë akoma të painformuar për CBAM-in për shkak të komunikimit të kufizuar institucional, aktiviteteve të pamjaftueshme informuese dhe mungesës së udhëzimeve teknike nga autoritetet publike.

Pajtueshmëria dhe ndikimi në treg: Përkundër angazhimit aktiv për përmbushjen e kërkesave të CBAM-it, EuroMetal nuk e sheh mekanizmin si kërcënim të menjëhershëm për performancën e saj eksportuese. Kompania vlerëson se kostot që lidhen me CBAM-in do të bien kryesisht mbi importuesit në BE, veçanërisht duke pasur parasysh konkurrueshmërinë e produkteve të saj në tregun evropian. Megjithatë, i intervistuari nënvizoi se përgjegjësia për raportimin dhe përmbushjen e kërkesave të CBAM-it mbetet te eksportuesi. Në këtë aspekt, monitorimi i saktë i emetimeve dhe raportimi transparent konsiderohen thelbësorë jo vetëm për respektimin e kërkesave rregullatore, por edhe për ruajtjen e besimit dhe vazhdimësisë së marrëdhënieve me klientët në BE.

Përdorimi i energjisë dhe intensiteti i karbonit: Karakteristikë e rëndësishme e operacioneve të EuroMetal-it është orientimi drejt energjisë së ripërtëritshme. Aktualisht, kompania funksionon me energji elektrike të prodhuar në tërësi nga sistemi i saj i paneleve solare, pas investimeve të konsiderueshme në kapacitete fotovoltaike. Ky transformim nuk u nxit nga subvencionet apo mbështetja publike, por nga strategjia e vet kompanisë dhe rritja e kostove të energjisë elektrike pas liberalizimit të tregut. Përgjatë viteve, kompania ka investuar në rreth 400 kW kapacitet fotovoltaike, të financuar plotësisht në baza vetanake. Përveç mbulimit të nevojave të veta energjetike, EuroMetal shet edhe energjinë e tepërt në treg, duke krijuar kështu një burim shtesë të hyrash dhe duke përmirësuar efikasitetin operacional. Kohëve të fundit, kompania është përzgjedhur në listën e ngushtë të përfituesve potencialë të një granti për instalimin e sistemeve të akumulimit të energjisë përmes baterive, çka do të rriste më tej fleksibilitetin energjetik dhe nivelin e vetëkonsumit.

Konteksti institucional dhe sfidat e mbetura: Pavarësisht progresit të arritur brenda kompanisë, i intervistuari vuri në dukje boshllëqe të mëdha institucionale në ekosistemin e CBAM-it në Kosovë. Një nga shqetësimet kryesore është mungesa e kapaciteteve vendore të akredituara për verifikim dhe auditim sipas kërkesave të CBAM-it, gjë që krijon vështirësi në përmbushjen e standardeve të kërkuara nga BE-ja. Krahas kësaj, si pengesa kryesore për eksportuesit që u duhet të përshtaten me kërkesat e reja u përmendën angazhimi i kufizuar institucional, mungesa e udhëzimeve teknike dhe mungesa e programeve të strukturuar të trajnimit. Sipas kompanisë, megjithëse kompani individuale si EuroMetal po shënojnë përparim të dukshëm, mungesa e një kornize të koordinuar institucionale rrezikon të ngadalësojë gatishmërinë e sektorit për t'iu përshtatur me mjedisin e ri rregullator.

Po kështu, sipas një interviste me përfaqësues të Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), ndërgjegjësimi i bizneseve në Kosovë për CBAM-in vazhdon të jetë i kufizuar. OEK theksoi se shumë kompani vazhdojnë të kenë vështirësi në kuptimin e kërkesave të raportimit, llogaritjes së emetimeve të inkuorpuara në produkte dhe përmbushjen e kriterëve të dokumentacionit teknik që kërkohet në kuadër të këtij mekanizmi. Për t'i adresuar këto sfida, OEK ka përgatitur një udhëzues praktik për bizneset e prekura nga CBAM,⁶⁹ ku përvijohen detyrimet kryesore për raportim dhe kërkesat për pajtueshmëri sipas mekanizmit. OEK vlerëson se nevojiten më shumë aktivitete informuese dhe trajnime shtesë, veçanërisht duke pasur parasysh se kërkesat e CBAM-it janë shpesh komplekse dhe pritet të bëhen gjithnjë e më kërkuese në të ardhmen.

Ulja e atraktivitetit për investime

Implikim tjetër që lidhet me ekspozimin sektorial ndaj CBAM-it, siç është vënë në dukje edhe nga Komuniteti i Energjisë, është se CBAM mund të ndikojë në sinjalet investuese në mbarë rajonin, veçanërisht në sektorin e energjisë elektrike.⁷⁰ Me rastin e marrjes së vendimeve për investime afatgjata, investitorët po marrin gjithnjë e më shumë në konsideratë tarifimin e emetimeve të karbonit dhe harmonizimin e politikave klimatike. Vonesat në përmbushjen e kërkesave që lidhen me CBAM-in mund të krijojnë pasiguri rregullatore dhe të dekurajojnë investimet në burime të ripërtëritshme të energjisë, dekarbonizim industrial dhe industri të orientuara drejt eksportit.⁷¹ Sipas CBAM-it, eksportuesit duhet të matin, monitorojnë dhe raportojnë emetimet e gazrave serrë të inkuorpuara në produktet e tyre, duke përdorur metodologjitë e BE-së. Për ta bërë këtë gjë nevojiten sisteme për gjurmimin e emetimeve, mbledhje të besueshme të të dhënave dhe, në disa raste, verifikim nga palë të treta. Për shumë kompani, veçanërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, kjo mund të jetë teknikisht e vështirë dhe e kushtueshme për shkak të kërkesave shtesë për raportim. Në praktikë, kompanitë shpesh duhet të krijojnë procese të reja të brendshme dhe të trajnojnë stafin për t'i përmbushur këto detyrime. Disa kompani mund të kenë nevojë të angazhojnë edhe ekspertë të jashtëm, gjë që rrit edhe më tej kostot e tyre.

Nga ana tjetër, trendet e tregtimit të energjisë elektrike, si produkt me intensitet të lartë emetimi të karbonit që hyn në fushëveprimin e CBAM-it, tregojnë se vëllimi i importeve të energjisë elektrike nga vendet e Ballkanit Perëndimor drejt Bashkimit Evropian ka rënë me rreth 25% në tremujorin e parë të këtij viti, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025.⁷² Kostot e lidhura me CBAM-in dhe pasiguria rregullatore duket të kenë ulur atraktivitetin e tregtisë së energjisë elektrike nga Ballkani Perëndimor drejt BE-së. Si rrjedhojë, tregje të BE-së me çmime më të larta, si Italia, Rumania, Bullgaria dhe Kroacia, nuk kanë arritur të përfitojnë plotësisht nga energjia elektrike me kosto më të ulët e prodhuar nga gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor.⁷³ Eksportet e energjisë elektrike të Kosovës drejt vendeve të BE-së përbënin 43% të eksporteve totale të energjisë elektrike në vitin 2021 dhe arritën nivelin më të lartë në vitin 2022, me 71%, para se të binin ndjeshëm në vetëm 0.5% në vitin 2025.⁷⁴ Gjatë së njëjtës periudhë, eksportet e përgjithshme të energjisë elektrike në fakt u rritën ndjeshëm, por kjo rritje ishte thujtë tërësisht rezultat i tregtisë me vendet e rajonit që nuk janë pjesë e BE-së.⁷⁵

69 Oda Ekonomike e Kosovës (OEK). [Udhëzues hap-pas-hapi për CBAM-in](#). 2024

70 Komuniteti i Energjisë. [Raport tremujor për CBAM-in. 2026/1. f.3](#)

71 Po aty.

72 Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Raport tremujor për CBAM-in. 2026/1.

73 Po aty, f. 7.

74 Të dhënat e Doganës së Kosovës mbi eksportet vjetore për periudhën 2021-2025.


75 Po aty.

Tabela 9. Eksportet e energjisë elektrike të Kosovës, 2021–2025 (vlera në euro)

	2021	2022	2023	2024	2025
BE	4,364,094	45,014,962	5,520,167	11,829,815	249,567
Jo BE	5,724,234	18,202,890	14,541,086	138,641,105	54,920,254
BE si %	43.30%	71.20%	27.50%	7.90%	0.5%

Burimi: Dogana e Kosovës

Eksportet e energjisë elektrike të Kosovës drejt shteteve anëtare të BE-së arritën kulmin në vitin 2022 me 45 milionë euro, me eksportin më të lartë në Slloveni me 25.3 milionë euro dhe në Danimarkë me 16.3 milionë euro, para se të shënonin rënie të ndjeshme në vitin pasues (2023). Në vitin 2024 pati një rimëkëmbje të pjesshme, me eksporte në vlerë prej 11.8 milionë eurosh, por në vitin 2025 eksporti ra në vetëm 249,567 euro (për më shumë hollësi rreth vendeve të destinacionit, shih Tabelën 2 në Shtojcë).⁷⁶ Rënia e eksporteve të energjisë elektrike drejt BE-së pas vitit 2022 është rezultat i zbehjes së bumit të përkohshëm të eksporteve, i nxitur nga çmimet jashtëzakonisht të larta të energjisë elektrike në Evropë gjatë krizës energjetike, ndërkohë që kufizimet strukturore të Kosovës, si pamjaftueshmëria e prodhimit dhe rritja e kërkesës së brendshme, vazhduan ta kufizojnë kapacitetin eksportues.⁷⁷

Figura 4. Eksportet e energjisë elektrike të Kosovës drejt BE-së, 2021–2025 (në euro)

Burimi: Dogana e Kosovës

CBAM krijon sfida shtesë për tregtinë e energjisë elektrike të Kosovës. Përveç rritjes së kostos dhe uljes së atraktivitetit të eksporteve të energjisë elektrike drejt BE-së, CBAM prek në mënyrë të ngjashme të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor duke inkurajuar potencialisht tregtimin e energjisë elektrike brenda rajonit në vend të orientimit drejt tregut të BE-së.⁷⁸ CBAM përbën ndërlikim edhe për përpjekjet e Kosovës për ta integruar tregun e saj të energjisë elektrike me vendet fqinje dhe me BE-në. Çiftëzimi i tregut me atë të BE-në nuk është në pajtueshmëri me CBAM-in nëse Kosova nuk arrin ta harmonizojë sistemin e vet të tarifimit të emetimeve të karbonit me rregullat e BE-së dhe nuk siguron përjashtime. Megjithatë, integrimi më i thellë në tregun e energjisë elektrike të BE-së është i rëndësishëm për Kosovën, pasi mund të forcojë sigurinë energjetike, të përmirësojë likuiditetin e tregut dhe të lehtësojë integrimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë.⁷⁹

⁷⁶ Kosovo Customs. [Open Data: Trade Balance](#). 2021 – 2025.

⁷⁷ FMN. Çështje të përzgjedhura. Bella, D.B dhe Thaqi, S. [Sfidat dhe mundësitë e sektorit të energjisë elektrike të Kosovës](#). 2023.

⁷⁸ Republika e Kosovës. Zyra e Kryeministrit. [Plani kombëtar për energji dhe klimë i Republikës së Kosovës 2025–2030](#). f. 120.

⁷⁹ Ekipi Ekonomik Gjerman (GET). [Implikimet e CBAM për Kosovën dhe sektorin e saj të energjisë elektrike](#). 2025

Një analizë e realizuar së fundmi nga Komuniteti i Energjisë sugjeron se CBAM tashmë po ndikon në modelet e tregtimit të energjisë elektrike ndërmjet BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke kontribuar në uljen e flukseve të energjisë elektrike dhe në dobësimin e integritimit të tregjeve.⁸⁰ Rreziku më i madh për Kosovën lidhet me sektorin e energjisë elektrike. Meqë prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë mbështetet në masë të madhe në termocentralet me thëngjill, energjia elektrike që eksportohet ka intensitet të lartë të emetimeve të karbonit.⁸¹ Rregullorja e BE-së parasheh mundësinë e një përjashtimi të kufizuar në kohë për importet e energjisë elektrike nga shtete anëtare të Komunitetit të Energjisë, por vetëm nëse këto të fundit arrijnë ta bëjnë çiftëzimin e tregut të energjisë elektrike me BE-në dhe përmbushin disa parakushte të politikave klimatike dhe energjetike. Vonesat në zbatimin e reformave të nevojshme ulin mundësinë që Kosova të sigurojë një përjashtim të tillë në të ardhmen e afërt.⁸²

Në vitin 2025, Komisioni Evropian nisi një konsultim publik për zgjerimin e mundshëm të CBAM-it në produktet e përpunuara më tej në zinxhirin e vlerës, me fokus të veçantë në mallrat që përdorin në mënyrë intensive çelikut dhe aluminin, një nismë kjo që reflekton dispozitat e Rregullores për CBAM-in që parashohin vlerësimin e mundësisë së zgjerimit të mekanizmit në faza të tjera të zinxhirit të vlerës për të adresuar rrezikun e rrjedhjes së karbonit.⁸³ Po ashtu, krahas EU ETS ekzistues, që mbulon sektorët industrialë me konsum të lartë energjie,⁸⁴ në vitin 2023 u krijua edhe një sistem i ri i njohur si EU ETS 2. Ky sistem i ri trajton emetimet e CO₂ që rrjedhin nga përdorimi i karburanteve në ndërtesa, transport dhe sektorë të tjerë, veçanërisht industri të vogla që nuk përfshihen në fushëveprimin e EU ETS ekzistues.⁸⁵ EU ETS 2 synon të nxisë investimet në rinovimin e objekteve dhe në alternativa transporti me emetime të ulëta, dhe pritet të hyjë në zbatim të plotë nga viti 2027.

Megjithëse EU ETS 2 nuk do të zbatohet drejtpërdrejt në Kosovë, pritet të ketë ndikime të tërthorta përmes rritjes së kostove të transportit dhe integritimit me tregun e BE-së. Duke rritur çmimet e karburanteve në BE, ky sistem do të shpie në rritje të shpenzimeve logjistike, që mund t'i bëjë eksportet e Kosovës më të shtrenjta dhe më pak konkurruese, veçanërisht mallrat me intensitet të lartë transporti. Me kalimin e kohës, ai do të rrisë edhe kërkesën për produkte me emetime të ulëta karboni, duke shtuar presionin mbi eksportuesit kosovarë që të përmirësojnë eficiencën dhe të ulin emetimet për ta ruajtur konkurrueshmërinë në tregjet e BE-së.

— 2.3. Disa implikime të CBAM në politika

Meqenëse Kosova aktualisht nuk ka as taksë karboni dhe as ETS, eksportuesit e saj nuk disponojnë me ndonjë mekanizëm vendor për tarifimin e emetimeve të karbonit që do të mund të kualifikohej si zbritje sipas rregullave të CBAM-it.⁸⁶ Nëse Kosova do të kishte një mekanizëm të tillë të njohur nga BE-ja, si një ETS apo taksë karboni, tarifatat për emetimet e karbonit të paguara në Kosovë nga prodhuesit vendorë do të mund të zbriteshin nga detyrimet sipas CBAM-it. Kjo do të mundësonte mes tjerash edhe që të hyrat nga tarifimi i emetimeve të karbonit të mbeteshin në Kosovë, në vend se të transferohen në BE përmes pagesave të CBAM-it. Vonesat në përmbushjen e kërkesave që lidhen me CBAM-in krijojnë disa rreziqe për Kosovën. Disa nga rreziqet e drejtpërdrejta janë sa vijon:

80 Komuniteti i Energjisë. [Raporti i ri evedenton transformime të thella në tregun e energjisë elektrike në Evropën Juglindore si pasojë e hyrjes në fuqi të CBAM-it](#). 2026.

81 Po aty.

82 Komuniteti i Energjisë. [Sekretariati publikon Monitoruesin e ri të gatishmërisë për CBAM të Komunitetit të Energjisë](#). 2024

83 Bashkimi Evropian Union. CBAM: [Konsultim publik për zgjerimin e CBAM-it për produktet e përpunuara më tej në zinxhirin e vlerës](#). 2025

84 Komisioni Evropian. [Fushëveprimi i EU ETS](#).

85 Po aty. ETS2: [Ndërtesat, transporti rrugor dhe sektorë tjerë](#).

86 Komisioni Evropian. [Mekanizmi i rregullimit të kufirit për karbon](#).

Humbja e konkurrueshmërisë në tregjet e BE-së

Nëse Kosova vonon përafrimin e politikave të saj me kërkesat e CBAM-it, eksportuesit e mallrave për të cilat zbatohet CBAM do të përballen me detyrime më të larta efektive për emetimet e karbonit me rastin e qasjes në tregun e BE-së. Meqenëse importuesve në BE tani u duhet të blejnë certifikata CBAM që pasqyrojnë emetimet e inkorporuara në mallrat e importuara, produktet me intensitet të lartë emetimi të karbonit bëhen më pak konkurruese krahasuar me alternativat e prodhuara në BE.⁸⁷ Duke qenë se eksportet për të cilat zbatohet CBAM aktualisht përbëjnë një pjesë relativisht të vogël të eksporteve të përgjithshme, ndikimi i menjëhershëm tregtar për Kosovën është disi i kufizuar, megjithatë mekanizmi mund ta dekurajojë zgjerimin e ardhshëm të eksporteve me intensitet të lartë karboni drejt BE-së.⁸⁸

Ndryshimi i flukseve tregtare

CBAM mund ta riorientojë fluksin tregtar drejt shteteve me metoda më të pastra prodhimi. Një analizë e OECD-së sugjeron se importet në BE mund të zhvendosen nga furnizuesit me intensitet të lartë karboni drejt prodhuesve me efikasitet më të lartë të karbonit. Shtetet që nuk arrijnë të dekarbonizojnë prodhimin mund të humbasin pjesë të tregut në BE.⁸⁹ Ngjashëm, Komisioni Evropian vlerëson se CBAM synon të krijojë kushte të barabarta konkurrence ndërmjet prodhuesve të BE-së dhe atyre jashtë BE-së përmes harmonizimit të detyrimeve që lidhen me emetimet e karbonit, e që mund të rezultojë me tkurrje të tregut për eksportuesit që nuk i dekarbonizojnë mallrat. Me kalimin e kohës, eksportuesit që investojnë në prodhim më të pastër ose që i nënshtrohen tarifimit vendor të emetimeve të karbonit do të jenë më mirë të pozicionuar për të ruajtur qasjen në tregun e BE-së, ndërkohë që prodhuesit me intensitet të lartë emetimi të karbonit rrezikojnë të zëvendësohen në zinxhirët e furnizimit të BE-së.

3. Tranzicioni i drejtë, punësimi dhe aftësitë

3.1. Ndikimi rajonal dhe social

Tranzicioni drejt një ekonomie me emetime të ulëta karboni është komponent thelbësor i adresimit të ndryshimeve klimatike, por shoqërohet edhe me sfida të mëdha për tregun e punës. Punëtorët në sektorët e lëndëve djegëse me prejardhje fosile dhe në sektorë të tjerë me intensitet të lartë karboni mund të përballen me humbje të vendeve të punës nëse tranzicioni nuk menaxhohet me kujdes.⁹⁰ Ky rrezik është veçanërisht i dukshëm në rajonet që varen nga thëngjilli, nafta dhe gazi, apo nga industria e rëndë, ku diversifikimi i kufizuar ekonomik i bën komunitetet lokale më të cenueshme ndaj goditjeve strukturore ekonomike.⁹¹

Për ta zbutur ndikimin e tranzicionit të gjelbër në tregun e punës dhe te punëtorët, disa shtete kanë filluar të hartojnë strategji, udhërrëfytes apo plane veprimi për punësim dhe zhvillim të shkathësive.⁹² Parlamenti Evropian, në zgjidhjen e tij për krijim të vendeve të punës dhe tranzicion të drejtë, thekson se dekarbonizimi duhet të jetë i drejtë në aspektin social dhe të sigurojë që asnjë punëtor apo rajon të mos mbetet pas. Ai gjithashtu vë në pah "të drejtën për kalim nga një

87 Pietras, J. Fondacioni Konrad Adenauer. Klima dhe energjia në Bashkimin Evropian. [Mekanizmi i rregullimit të kufirit për karbonin \(CBAM\) i BE-së: Mundësitë, sfida dhe rreziqet e ardhshme](#). 2026.

88 Tahmisoğlu, Y., Ekipi Ekonomik Gjerman. [Implikimet e CBAM-it për Kosovën dhe sektorin e saj të energjisë elektrike](#). 2025.

89 OECD. [Çfarë mund të pritët nga Mekanizmi për rregullimit e kufirit për karbon?](#) 2025.

90 Calice, P. dhe Murciego, M.G. Blogje të Bankës Botërore, [Nga pluhur thëngjilli në vende të gjelbra pune: Imperativi i punësimit në tranzicionin drejt një ekonomie me emetime të ulëta të karbonit](#). 2025.

91 Po aty.

92 OECD. [Politikat e punësimit dhe aftësive për tranzicionin e gjelbër](#). 2025.

vend pune në një tjetër" përmes qasjes në rikualifikim dhe avancim aftësish falas, si dhe Fondin për Tranzicion të Drejtë⁹³ si instrument kyç për adresimin e ndikimeve sociale të tranzicionit të gjelbër.⁹⁴

Kosova nuk ka hartuar akoma një kornizë gjithëpërfshirëse për "tranzicion të drejtë" ekuivalente me mekanizmin për tranzicion të drejtë të BE-së. Strategjia e Energjisë 2022–2031 parasheh dekarbonizimin gradual të sektorit të energjisë dhe rritjen e përdorimit të burimeve të ripërtëritshme, gjë që sjell në shprehje nevojën për përshtatjen e fuqisë punëtore, sidomos në rajonet e varura nga thëngjilli.⁹⁵ Edhe detyrimet që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë⁹⁶ po e shtojnë Kosovën drejt përafrimit me rregullat klimatike dhe energjetike të BE-së, duke e bërë të domosdoshme përgatitjen për ndryshimet në tregun e punës që do të lindin nga tranzicioni.

Në këtë kontekst, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), ndërmarrje publike që zotëron dhe operon me asetet për prodhimin e energjisë elektrike, ka gjithsej 3,323 të punësuar,⁹⁷ kryesisht në termocentrale dhe në operacionet e nxjerrjes së linjitet.⁹⁸ Struktura moshore e fuqisë punëtore të KEK-ut përbën sfidë të madhe për qëndrueshmërinë afatgjatë të sektorit energjetik të Kosovës. Me një moshë mesatare prej 58 vjetësh dhe vetëm rreth 7% të punëtorëve në grupmoshën 19–30 vjeç, një pjesë e madhe e fuqisë punëtore po i afrohet pensionimit.⁹⁹ Çdo vit pensionohen gati 200 punëtorë,¹⁰⁰ ndërsa fakti që rreth 19% e të punësuarve janë të moshës 61–65 vjeç tregon se një numër i konsiderueshëm punëtorësh pritet të dalin në pension në vitet e ardhshme.¹⁰¹ Kjo krijon rrezik për humbjen e përvojës dhe njohurive teknike, ndërkohë që numri i ulët i punëtorëve të rinj mund ta vështirësojë zëvendësimin e atyre që pensionohen dhe ruajtjen e fuqisë së nevojshme punëtore në vitet në vijim. Këto sfida janë veçanërisht të rëndësishme në kontekstin e tranzicionit të drejtë, sipas të cilit punëtorët duhet të zhvillojnë aftësi të reja dhe të përshtaten me teknologjitë në ndryshim. Struktura moshore e fuqisë punëtore të KEK-ut mund ta vështirësojë ruajtjen e aftësive ekzistuese dhe njëherazi zhvillimin e aftësive të reja.

Tabela 10. Struktura moshore e fuqisë punëtore të KEK-ut

Mosha	<18	19–30	31–45	46–60	61–65
Përqindja	0.1%	7.4%	23%	49.6%	20%

Burimi: Instituti Atlas

Një pjesë e madhe e territorit të Obiliqit, rreth 65–68%, është në pronësi të KEK-ut, që nënkupton se sektori ka rol vendimtar si për zhvillimet ekonomike, ashtu edhe për ato mjedisore në këtë zonë. Sipas të dhënave të regjistrimit të popullsisë të vitit 2024, në sektorin e furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar ishin të punësuar 7,407 persona, ose 1.7% e numrit të përgjithshëm të të punësuarve në Kosovë.¹⁰²

93 Fondi për Tranzicion të Drejtë, pjesë e Politikës së kohezionit të BE-së 2021–2027, mbështet rajonet më të prekura nga tranzicioni drejt neutralitetit klimatik me qëllim zvogëlimin e pabarazive rajonale. Krahas kësaj, ai përfshin edhe një platformë që ndihmon vendet dhe rajonet të kenë qasje në instrumentet përkatëse mbështetëse. Komisioni Evropian, [Fondi për Tranzicion të Drejtë](#).

94 Parlamenti Evropian. [Tranzicioni i drejtë në botën e punës](#). 2025, f. 10.

95 Ministria e Ekonomisë. [Strategjia për energji e Republikës së Kosovës 2022–2031](#).

96 Komuniteti i Energjisë. [Raportimi i Kosovës](#).

97 KEK Sh.A. [Raporti vjetor 2024](#).

98 Instituti Atlas. [Fuqia punëtore në sektorin e thëngjillit në Kosovë](#). 2025.


99 Po aty, f. 30.

100 KEK. [Raportet vjetore për 2023 dhe 2024](#).

101 Kosovo Energy. [KEK-ut i nevojitet përtëritje gjeneratash – mbi 600 punonjës pritet të dalin në pension gjatë tre viteve të ardhshme](#). 2025.

102 Nga ky total, 6,901 janë burra dhe 506 janë gra. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), [Raport tematik: Të dhënat e tregut të punës sipas komunave, ReKos 2024](#). 2026.


Figura 5. Punësimi në sektorin e energjisë elektrike, gazit, avullit dhe kondicionimit të ajrit sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë të vitit 2024



Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK)

Nga aspekti gjeografik, Prishtina ka përqendrimin më të lartë të punësimit në këtë sektor, me 1,489 punëtorë, pasuar nga Obiliqi me 983 punëtorë, Fushë Kosova me 753 punëtorë, Vushtrria me 608 punëtorë dhe Podujeva me 276 punëtorë. Nga ana tjetër, punësimi në sektorin e minierave dhe gurorëve përbën një pjesë të vogël të punësimit të përgjithshëm në Kosovë, përkatësisht 0.6%. Të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2024 tregojnë se rreth 2,850 persona janë aktualisht të punësuar në miniera dhe gurorë.¹⁰³ Punësimi në këtë sektor është po ashtu shumë i përqendruar në një numër të vogël komunash. Mitrovica Jugore ka numrin më të lartë të të punësuarve në miniera dhe gurorë, me 676 punëtorë, e ndjekur nga Glllogoci me 398 punëtorë dhe Prishtina me 234 punëtorë.

Figura 6. Punësimi në sektorin e minierave dhe gurorëve sipas të dhënave nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2024



Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK)

Sipas Ministrisë së Ekonomisë, zbatimi i Strategjisë për miniera 2012–2025 ka kontribuar në zhvillimin e sektorit minerar përmes zgjerimit të kapaciteteve prodhuese, zhvillimit të infrastrukturës dhe hapësirave moderne, si dhe

103 Nga ky total, 2,658 janë burra dhe 192 janë gra. Po aty.

përmirësimet të performancës së gjithmbarshme.¹⁰⁴ Shfrytëzimi i burimeve minerare konsiderohet një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të punës në Kosovë.¹⁰⁵ Sektori mineral jep një kontribut të rëndësishëm në buxhetin e shtetit, ku në vitin 2025 të hyrat nga rentat minerare dhe licencat për gurore dhe miniera arritën në 25.5 milionë euro.¹⁰⁶ Për më tepër, sipas vlerësimeve të mëhershme, kontributi i tërthortë i aktivitetit mineral në të hyrat buxhetore vlerësohet të jetë ndërmjet 150 dhe 200 milionë euro në vit.¹⁰⁷

Megjithatë, kjo rëndësi fiskale, së bashku me faktin se sektori mineral mbetet një burim i rëndësishëm punësimi në disa rajone të Kosovës, paraqet një sfidë të veçantë në kontekstin e tranzicionit të drejtë. Përqendrimi i vendeve të punës në industri me intensitet të lartë emetimi të karbonit ngre shqetësime të mëdha lidhur me sigurinë e punësimit në të ardhmen dhe nevojën për politika të fokusuar të rikualifikimit dhe zhvillimit ekonomik rajonal.

3.2. Kornizat e politikave dhe mbrojtja sociale

Një nga sfidat kryesore të tranzicionit energjetik në Kosovë është ritmi i ngadalshëm i zhvillimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë (BRE) dhe vazhdimi i varësisë nga thëngjilli. Aktualisht, burimet e ripërtëritshme të energjisë përbëjnë vetëm rreth 8% të konsumit final të energjisë,¹⁰⁸ kurse më se 90% e energjisë elektrike vazhdon të prodhohet nga thëngjilli.¹⁰⁹ Kjo shkallë e lartë varësie nënkupton se një pjesë e konsiderueshme e vendeve të punës në sektorin energjetik është e lidhur drejtpërdrejt me prodhimin e energjisë elektrike nga linjiti. Në këtë kontekst, KEK-u vazhdon të jetë punëdhënësi më i madh në sektor.

Niveli i informimit dhe ndërgjegjësimet të punëtorëve për konceptin e tranzicionit të drejtë vijon të jetë i ulët.¹¹⁰ Gjetjet e hulumtimeve tregojnë se ndërgjegjësimi i ulët, i kombinuar me mungesën e programeve të strukturuar të trajnimit dhe të një planifikimi të qartë të tranzicionit, ka kontribuar në skepticizëm të punëtorët.¹¹¹ Si rrjedhojë, shumë të punësuar presin që prodhimi i energjisë elektrike nga thëngjilli të vazhdojë edhe për shumë vite, duke krijuar kështu perceptimin se tranzicioni drejt burimeve të ripërtëritshme të energjisë nuk pritet të ndodhë menjëherë apo në një të ardhme të afërt. Pra, ata vazhdojnë ta shohin prodhimin e energjisë nga thëngjilli si burim të qëndrueshëm punësimi dhe nuk parashikojnë ndonjë rrezik të madh për vendet e tyre të punës, perceptim ky që lidhet kryesisht me investimet e vazhdueshme për mirëmbajtjen dhe modernizimin e kapaciteteve ekzistuese të prodhimit të energjisë elektrike.¹¹² Si rezultat, nismat për rikualifikim, avancim të aftësive dhe planifikim afatgjatë të karrierës nuk kanë marrë vëmendjen e nevojshme.

Në kontekstin e tranzicionit të drejtë, Kosova është palë kontraktuese e Komunitetit të Energjisë dhe është e obliguar që të transpozojë në legjislacionin vendor elementet përkatëse të legjislacionit të BE-së në fushën e energjisë.¹¹³ Këtu përfshihen edhe dispozitat e Direktivës për energjinë elektrike (BE) 2019/944 që kërkon mesh tjerash që shtetet ta vlerësojnë numrin e ekonomive familjare të prekura nga varfëria energjetike dhe, sipas nevojës, të zbatojnë

104 Ministria e Ekonomisë. [Raport i progresit për vitin 2022 lidhur me zbatimin e Strategjisë për miniera 2012–2025](#), f. 4.

105 Ministria e Ekonomisë. [Strategjia për miniera e Republikës së Kosovës 2012–2025](#), 2012, f. 7.

106 Ministria e Financave. [Raport vjetor financiar 2025](#), f. 19.

107 Ministria e Ekonomisë. [Raport i progresit për vitin 2022 lidhur me zbatimin e Strategjisë për miniera 2012–2025](#), f. 6.

108 Përfshirë prosumatorët.

109 Qendra për Zhvillim e OECD-së. [Çmimet e energjisë dhe subvencionet në Ballkanin Perëndimor, 2025](#), f. 272.

110 Instituti Atlas. [Fuqia punëtore në sektorin e thëngjillit në Kosovë, 2025](#).

111 Po aty.

112 Po aty.

113 Komuniteti i Energjisë. [Korpusi ligjor i Komunitetit të Energjisë \(acquis\)](#)

masa për adresimin e saj.¹¹⁴ Megjithatë, Kosova ende nuk ka të përcaktuar një përkufizim të varfërisë energjetike në kornizën ligjore. Strategjia për energji e Republikës së Kosovës 2022–2031 u referohet shkarazi konsumatorëve të cenueshëm në kuadër të objektivës së pestë specifike, pa përcaktuar qartë se si duhet të identifikohen dhe mbështeten këto kategori, gjë që e vështirëson matjen e saktë të përmasave të problemit.¹¹⁵ Adresimi i varfërisë energjetike konsiderohet komponent thelbësor i tranzicionit të drejtë energjetik dhe është prioritet i theksuar edhe në Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane.¹¹⁶

Krahas mbrojtjes së konsumatorëve të cenueshëm, tranzicioni i drejtë nënkupton edhe adresimin e pasojave sociale dhe ekonomike të dekarbonizimit për punëtorët dhe komunitetet që varen nga industrinë e lëndëve djegëse me prejardhje fosile. Përvoja ndërkombëtare dëshmon tregun se vendet e zhvilluara me varësi të lartë nga thëngjilli për prodhimin e energjisë elektrike kanë ndërmarrë hapa drejt tranzicionit energjetik duke i kushtuar vëmendje transferimit të shkathtësive të punëtorëve. Shembull i tillë është projekti Re-Skill, i cili u zbatua në gjashtë shtete të varura nga thëngjilli, gjegjësisht në Austri, Bullgari, Gjermani, Greqi, Poloni dhe Rumania, me fokus tranzicionimin e punëtorëve të sektorit të thëngjillit drejt sektorit të energjisë nga burime të ripërtëritshme, veçanërisht energjisë së erës dhe asaj diellore.¹¹⁷ Gjetja kryesore ishte se aftësitë mund të transferohen nëpër shtete dhe rajone të ndryshme, ngaqë sektori i thëngjillit ka strukturë të ngjashme vlerë dhe profil të ngjashëm aftësish në nivel global. Rrjedhimisht, "për shkak të kërkesave të krahasueshme për aftësi, punëtorët e sektorit të thëngjillit janë, në parim, të përshtatshëm për t'u punësuar në sektorin e energjisë së ripërtëritshme."¹¹⁸ Për më tepër, njohuritë teknike të punëtorëve të këtij sektori nuk kufizohen vetëm në prodhimin e energjisë nga era dhe dielli, por mund të zbatohen edhe në burime të tjera të ripërtëritshme, si hidroenergjinë dhe biomasën.¹¹⁹

Gjermania, në suazat e përkushtimit të saj për kalimin drejt një sektori energjetik më të gjelbër dhe për eliminimin gradual të prodhimit të energjisë elektrike nga thëngjilli, ka krijuar skema të pensionimit të parakohshëm për minatorët si pjesë e planit për mbylljen graduale të aktiviteteve minerare dhe të njëjtën qasje po e vazhdon edhe në kuadër të objektivit për largimin e plotë nga thëngjilli më së voni deri në vitin 2038.¹²⁰ Për të arritur konsensus për largimin gradual nga thëngjilli dhe për ta mbështetur tranzicionin e drejtë duke i minimizuar njëherazi ndikimet sociale dhe ekonomike të tij, Qeveria gjermane ka themeluar madje Komisionin për Rritje Ekonomike, Ndryshim Strukturor dhe Punësim.¹²¹ Në rajonet e prekura janë promovuar investime të reja në sektorë si industria automobilistike, industria e lehtë dhe elektronike, si dhe është zgjeruar rrjeti i qendrave të kualifikimit dhe orientimit në karrierë, për shkak të nevojës për kualifikime shtesë përtej arsimit formal.¹²² Këto masa kanë përfshirë edhe kompensime për punëtorët e minierave që ndjekin trajnimet në këto qendra si mënyrë për ruajtjen e punësimit, veçanërisht të rinjve, si dhe politika tjera të ngjashme sociale që janë dëshmuar efektive.¹²³

114 Bashkimi Evropian. EU-Rex. [Dokument 32019L0944](#)

115 Ministria e Ekonomisë. [Strategjia për energji e Republikës së Kosovës 2022–2031](#).

116 Po aty. Agjenda e Marrëveshjes së Gjelbër. [Dokument 52019DC0640](#).

117 OECD. [Rikualifikimi i punëtorëve të industrisë së thëngjillit për sektorin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme](#). 2024

118 Komisioni Evropian. [RE-Skill: Rikualifikimi i punëtorëve të industrisë së thëngjillit për sektorin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme](#).

119 Po aty.

120 Që nga vitet e 60-ta, minatorët që punonin në miniera nëntokësore dhe ishin mbi 50 vjeç, si dhe punëtorët në sipërfaqe mbi 57 vjeç, kanë pasur të drejtë pensionimi të parakohshëm të financuar nga qeveria qendrore. GIZ, [Tranzicioni i drejtë \(energjetik\) si sfidë ndërdisiplinore e transformimit: Mësime nga përvoja gjermane](#). 2023. f. 18–19.

121 Instituti për Resurset Botërore. [Komisioni Gjerman për Thëngjillin: Udhëheqja e një procesi gjithëpërfshirës për largimin gradual nga thëngjilli](#). 2021

122 GIZ. [Tranzicioni i drejtë \(energjetik\) si sfidë ndërdisiplinore e transformimit: Mësime nga përvoja gjermane](#). 2023. f. 17–19.

123 Po aty. f. 8, 17–19.

Në përgjithësi, përvojat e Gjermanisë dhe shteteve të tjera të varura nga thëngjilli shpalosin se tranzicioni i drejtë nuk kufizohet vetëm në largim gradual nga lëndët djegëse fosile por kërkon edhe politika të koordinuara në fushën e tregut të punës, mbrojtjes sociale dhe zhvillimit rajonal. Për Kosovën, ku sektori energjetik vazhdon të ketë rëndësi të madhe ekonomike dhe sociale, këto përvoja janë veçanërisht të rëndësishme në kontekstin e përmbushjes së zotimeve për dekarbonizim. Është e rëndësishme të pranohet fakti se tranzicioni do të sjellë humbje të vendeve të caktuara të punës, por gjithashtu mund të krijojë më shumë vende të reja pune, madje vende pune më të mira sesa ato që humben.¹²⁴ Këto humbje mund të kompensohen nga rritja e punësimit në sektorë si energjia nga burimet e ripërtëritshme, eficientia e energjisë, ndërtimtaria, pylltaria dhe veprimtari të lidhura me pylltarinë.¹²⁵ Në mënyrë që ndryshimet strukturore në ekonomi të mos çojnë në papunësi afatgjatë, në këtë proces institucionet kanë rol kyç në përmirësimin e përputhjes së aftësive me kërkesat e tregut të punës dhe nxitjen e mobilitetit të fuqisë punëtore.¹²⁶

3.3. Rikualifikimi dhe zhvillimi i fuqisë punëtore

Rikualifikimi dhe zhvillimi i fuqisë punëtore janë thelbësore për sigurimin e një tranzicioni të drejtë energjetik në Kosovë, veçanërisht duke pasur parasysh mospërputhjet ekzistuese ndërmjet aftësive të fuqisë punëtore dhe kërkesave të tregut, si dhe faktin se sistemi i arsimit dhe aftësimit profesional nuk është mjaftueshëm i përafër me nevojat e një ekonomie me emetime të ulëta karboni.¹²⁷ Me largimin gradual të sektorit energjetik nga përdorimi i thëngjillit, do të jetë e domosdoshme që të zbatohen masa të fokusuara në rikualifikim dhe avancim të aftësive për t'i mbështetur punëtorët e prekur dhe për ta lehtësuar integrimin e tyre në industri të gjelbra.¹²⁸ Ndonëse përpjekjet në këtë drejtim vijojnë të jenë të kufizuara, disa nisma kanë kontribuar tashmë në forcimin e aftësive të nevojshme për tranzicionin energjetik. KEK-u ka një qendër të posaçme trajnimi, që ofron programe të përshtatura sipas nevojave të njësive të tij operacionale dhe pjesëmarrësve të jashtëm.¹²⁹ Në vitin 2024, rreth 118 kandidatë përfunduan kurse trajnimi, kryesisht në teknologji mekanike, menaxhim dhe administratë.¹³⁰ Megjithatë, akoma nuk janë krijuar programe trajnimi që lidhen konkretisht me tranzicionin e drejtë energjetik.¹³¹

Edhe sektori privat ka pasur rol në zhvillimin e fuqisë punëtore. Që nga themelimi i saj në vitin 2013, Akademia e KEDS-it ka trajnuar rreth 800 pjesëmarrës, duke i pajisur me aftësitë e kërkuara në sektorin energjetik.¹³² Ngjashëm, përgjatë një periudhe 24-mujore, programi "TechEco Pathway" ka pajisur rreth 75 pjesëmarrës me aftësi relevante për industrinë, përfshirë aftësi që lidhen me teknologjitë e energjisë nga burime të ripërtëritshme.¹³³ Nisma të tjera janë fokusuar drejtpërdrejt në zhvillimin e kapaciteteve nga burime të ripërtëritshme të energjisë, siç është rasti i projektit "SolarCollab" që ka ofruar trajnime të specializuara për energjinë diellore dhe instalimin e paneleve fotovoltaike për studentë universitarë.¹³⁴ Më tej, UNDP në Kosovë ka pilotuar një program trajnimi gjashtëjavor për instalimin e paneleve diellore, duke pajisur 28 profesionistë me aftësi praktike të rëndësishme për tranzicionin energjetik.¹³⁵ Projekti EYE

¹²⁴ Instituti GAP. [Kornizë strategjike për politikat industriale të gjelbra në Ballkanin Perëndimor](#). 2025.

¹²⁵ Po aty.

¹²⁶ 6 shtetet e Ballkanit Perëndimor. [Përmbledhje për Kosovën. Raport për klimën dhe zhvillimin e vendit](#). 2024. f. 30

¹²⁷ Po aty.

¹²⁸ Po aty.

¹²⁹ Instituti Atlas. [Fuqia punëtore në sektorin e thëngjillit në Kosovë](#). 2025.

¹³⁰ Korporata Energjetike e Kosovës. Raport vjetor 2024.

¹³¹ Instituti Atlas. [Fuqia punëtore në sektorin e thëngjillit në Kosovë](#). 2025.

¹³² KEDS Energy. [Akademia e KEDS - Aty ku fillon rrugëtimi drejt suksesit](#). 2025.

¹³³ Balkan Green Foundation. [Solarcollab: tranzicioni energjetik i udhëhequr nga rinia](#). 2023

¹³⁴ Po aty.

¹³⁵ UNDP. [28 profesionistë të paneleve solare të gatshëm për tregun e gjelbër të punës](#). 2023.

i Helvetas ka mbështetur po ashtu zhvillimin e fuqisë punëtore në sektorin e energjisë së ripërtëritshme, përmes trajnimit dhe certifikimit të inxhinierëve të parë të certifikuar për energji diellore në Kosovë, të kualifikuar për projektimin dhe instalimin e sistemeve fotovoltaike.¹³⁶

Edhe institucionet e arsimit të lartë po i zgjerojnë mundësitë në fusha të lidhura me energjinë. Gjatë periudhës 2022–2025, në programin e studimeve Termoenergjetikë dhe energjisë e ripërtëritshme të Universitetit të Prishtinës u regjistruan rreth 150 studentë.¹³⁷ Universiteti ka po ashtu edhe Qendrën për Energji të Ripërtëritshme dhe të Qëndrueshme që ofron kurse dhe një program certifikimi në fushën e qëndrueshmërisë energjetike.¹³⁸ Institucionet private të arsimit të lartë, përfshirë RIT Kosovo¹³⁹ dhe Kolegji UBT¹⁴⁰, ofrojnë programe studimi në inxhinieri energjetike, energji nga burime të ripërtëritshme dhe politika për energji. Megjithatë, ende ka mungesë të programeve të dedikuara arsimore dhe trajnuese që fokusohen në parimet e tranzicionit të drejtë, rikualifikimin e fuqisë punëtore dhe mbështetjen e komuniteteve të prekura nga dekarbonizimi.

Përveçsa u përmend më sipër, Strategjia e Energjisë thekson se për tranzicionin energjetik do të nevojitet të trajnohen si profesionistët ekzistues ashtu edhe ata të ardhshëm.¹⁴¹ Strategjia parasheh bashkëpunim ndërmjet qeverisë, institucioneve akademike, industrisë dhe partnerëve zhvillimorë për përafrimin e arsimit dhe aftësimin profesional me nevojat e sektorit, me fokus në fusha si integrimi i energjisë së ripërtëritshme, tregjet e energjisë elektrike dhe auditimi i energjisë, duke promovuar njëkohësisht edhe përfshirjen gjinore. Strategjia thekson më tej nevojën për rritjen e numrit të të diplomuarve në fusha të lidhura me energjinë, me qëllim mbështetjen e tranzicionit. Megjithatë, ajo nuk jep hollësi të mjaftueshme për adresimin e mospërputhjeve ekzistuese të aftësive apo për masat për rikualifikim të punëtorëve të prekur nga tranzicioni. Kjo ngre shqetësime lidhur me gatishmërinë e fuqisë aktuale punëtore për t'u përshtatur me ndryshimet strukturore në sektorin e energjisë, si dhe për rrezikun që punëtorët e prekur të mos mbështeten në mënyrë të mjaftueshme gjatë tranzicionit.

3.4. Masat sociale mbrojtëse dhe angazhimi i publikut

Kosova ka bazë formale ligjore për konsultimin mjedisor dhe publik.¹⁴² Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis, që synon të sigurojë që projektet me ndikim të madh në mjedis të lejohen për ndërtim apo investim vetëm pasi të jetë kryer vlerësimi përkatës dhe të jenë ndërmarrë masat e duhura për zbutje të ndikimit.¹⁴³ Kjo kornizë parasheh pjesëmarrje publike dhe transparencë gjatë procedurave të miratimit të projekteve. Projektet me ndikim të madh mjedisor, përfshirë shumë projekte të energjisë nga burimet e ripërtëritshme, duhet t'i nënshtrohen konsultimit publik para pajises me pëlqim mjedisor.^{144, 145} Në praktikë, institucione si Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) dhe Ministria e Ekonomisë publikojnë rregullisht për konsultim me palët e interesit projektligje, rregulla dhe mekanizma mbështetës që lidhen me energjinë nga burimet e ripërtëritshme, dhe ftojnë qytetarët, bizneset, komunat dhe shoqërinë civile që të parashtrajnë komente.¹⁴⁶

136 Helvetas. Rritja e punësimit të rinisë (EYE). [inxhinierët e parë solarë të certifikuar të Kosovës](#).

137 Universiteti i Prishtinës. [Termoenergjetikë dhe energji e ripërtëritshme](#).

138 Po aty. [Qendra për Energji dhe Qëndrueshmëri](#).

139 RIT Kosovo. [Nënplanet- Studimet për politika energjetike](#).

140 UBT. [Inxhinieri energjetike](#).

141 Ministria e Ekonomisë. [Strategjia për miniera e Republikës së Kosovës 2012–2025](#), 2012. f. 40.

142 Komuniteti i Energjisë. [Kosova miraton Ligjin për vlerësim të ndikimit mjedisor](#). 2022

143 Po aty.

144 Ministria e Ekonomisë. [Udhëzues A-Z për investime në energji nga burimet e ripërtëritshme në Kosovë](#). 2024.

145 REKO. Ekonomia qarkore në Kosovë. [Ligji nr. 08/L-181 për vlerësim të ndikimit mjedisor](#).

146 Ministria e Ekonomisë. [Ligji për burime të ripërtëritshme të energjisë është hapur për konsultime publike](#). 2022.

Megjithatë, Raporti vjetor mbi zbatimin për vitin 2025 i Komunitetit të Energjisë konstaton se, ndonëse Kosova ka bërë të ditur se konsultimi publik është i integruar në procedurën e dhënies së pëlqimit për investime, ky proces mbetet i kufizuar në praktikë, duke çuar në koordinim joefektiv dhe përfshirje jo të mirëfilltë të kushteve mjedisore në vendimet përfundimtare.¹⁴⁷ Në këtë kuptim, planifikimi i politikave ka përfshirë sesione konsultimi, por ato kryesisht janë zhvilluar ndërmjet institucioneve, jo me komunitetet lokale.¹⁴⁸

Për projekte të caktuara të energjisë nga burimet e ripërtëritshme, financuesit ndërkombëtarë kanë filluar ta kërkojnë angazhimin e komunitetit si parakusht për mbështetje. Për shembull, projekti i Bankës Botërore për mbështetjen përgatitore për energjinë nga burimet e ripërtëritshme në Kosovë kërkon angazhim të fuqishëm të palëve të interesit gjatë studimeve teknike, përfshirë vlerësimin e mbështetjes së komunitetit për lokacionet e parqeve të erës.¹⁴⁹ Ndonëse investimet e mëdha në energji nga burimet e ripërtëritshme po përqendrohen gjithnjë e më shumë në zona si Obiliqi, Mitrovica dhe Istogu, veçanërisht projekti Solar PV i KEK-ut në Obiliq,¹⁵⁰ parku i erës i Bajgorës në Mitrovicë¹⁵¹ dhe projektet fotovoltaike në Istog,¹⁵² angazhimi i publikut vazhdon të shtyhet kryesisht nga kërkesat e donatorëve, e jo nga një kuadër i qëndrueshëm kombëtar i konsultimit, duke çuar në nivele të pabarabarta të pjesëmarrjes së komuniteteve në projekte të energjisë nga burimet e ripërtëritshme.

Gjetjet nga dy takime me komunitetin, të mbajtura në Vushtrri dhe Obiliq, tregojnë se komunitetet në përgjithësi nuk e perceptojnë se konsultohen në mënyrë të mirëfilltë lidhur me vendimet që i prekin. Në Vushtrri, pjesëmarrësit theksuan se qytetarët ndihen të përjashtuar nga vendimmarrja lokale për projektet mjedisore dhe infrastrukturore. Në Obiliq, banorët pohuan se komuna organizon dëgjime publike, madje edhe më shumë se minimumi ligjor prej dy dëgjimesh në vit. Mirëpo, pjesëmarrja në këto dëgjime është e ulët dhe besueshmëria ndaj procesit është e dobët, meqë shumë qytetarë deklarojnë se nuk marrin pjesë ngaqë nuk besojnë se mendimet e tyre merren parasysh nga vendimmarrësit.¹⁵³

Në Obiliq, pjesëtarët e komunitetit në lokalitetet më afër termocentraleve raportojnë të jenë më të prekurit nga ndikimet mjedisore dhe se marrin shumë pak informata për mundësitë që lidhen me tranzicionin apo për skemat e kompensimit.¹⁵⁴ Këta banorë kanë kërkuar shprehimisht masa kompensimi, si tarifa të reduktuara të energjisë elektrike ose subvencione si përgjigje ndaj ekspozimit në ndotje mjedisore, duke bërë krahasime me praktikën në shtetet e zhvilluara, megjithatë aktualisht në Kosovë nuk ekzistojnë skema të tilla. Më tej, pjesëtarët e komunitetit u shprehën të pakënaqur edhe për faktin se, përkundër faktit se janë më të prekurit nga ndotja mjedisore, banorëve lokalë nuk u jepet përparësi për punësim në KEK, që përmbledhet më së miri me deklaratën "Ne jetojmë me ndotjen, ndërsa vendet e punës i marrin të tjerët." Bashkëpunimi i mëhershëm ndërmjet KEK-ut dhe entit komunal të punësimit (i nisur në vitin 2013), që kishte mundësuar punësimin e disa banorëve lokalë në KEK, u përmend si model pozitiv që mund të rivitalizohet, ndonëse sipas pjesëmarrësve ky mekanizëm nuk funksionon më. Në Vushtrri, ekonomitë familjare të prekura nga vërshimet theksuan se përballen me vështirësi të mëdha në përballimin e kostos së energjisë elektrike dhe kërkuan skema bashkëfinancimi nga komuna për të mbështetur qasjen në energjinë diellore.

147 Komuniteti i Energjisë. Kosova, Raport vjetor mbi zbatimin. 2024

148 Komuniteti i Energjisë. Plani kombëtar për energji dhe klimë i Republikës së Kosovës 2025-2030.

149 Banka Botërore. Mbështetje për përgatitjen për energji të ripërtëritshme në Kosovë (P505475). [Përmbledhje e vlerësimit mjedisor dhe social në fazën konceptuale. \(ESRS faza konceptuale\)](#). 2024

150 Banka Evropiane e Investimeve. [Key Solar PV- Global Gateway](#). 2024

151 Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). [Bajgora Wind](#)

152 Po aty. [Kosovo Solar – Tucep – Veriq](#)

153 Gjetjet nga takimet me komunitetin në Obiliq dhe Vushtrri.

154 Krushevc, Mazgiti dhe Hadeja janë lokalitete që ndodhen më së afërmi termocentraleve në Obiliq.

4. Financimi i tranzicionit energjetik

4.1. Nevojat për investime dhe hendeqet financiare

Për realizimin e objektivave dhe synimeve ambicioze për tranzicionin e gjelbër që Qeveria e Kosovës ka përcaktuar nevojiten investime të konsiderueshme, përfshirë në efikasitetin e energjisë, prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme, sistemet e akumulimit të energjisë, rehabilitimin e termocentraleve ekzistuese me thëngjill, modernizimin e rrjeteve të transmisionit dhe distribucionit, integrimin e tregut dhe dekarbonizimin e përgjithshëm të ekonomisë. Dy dokumentet kryesore kombëtare për tranzicionin energjetik, Strategjia e Energjisë dhe Draft Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë, përmbajnë vlerësime të përafërta të investimeve të nevojshme për arritjen e objektivave dhe synimeve të përcaktuara. Nevojat për investime për financimin e zbatimit të Strategjisë së Energjisë gjatë periudhës dhjetëvjeçare vlerësohen të jenë rreth tre miliardë euro. Kategoria më e madhe e investimeve lidhet me zhvillimin e kapaciteteve të reja nga burime të ripërtëritshme të energjisë, në shumën prej 1.3 miliardë eurosh, që pritet të financohen kryesisht nga sektori privat, krahas fondeve publike dhe granteve të donatorëve. Projekti që do të ketë nevojë për më së shumti financim nga fondet publike është rehabilitimi i termocentraleve ekzistuese me thëngjill, Kosova A dhe Kosova B, në shumën prej 390 milionë eurosh. Nevoja të konsiderueshme për investime janë identifikuar edhe në fushën e efikasitetit të energjisë, me vlerë prej rreth 350 milionë euro, që pritet të financohen përmes fondeve publike dhe private, si dhe granteve.¹⁵⁵

Tabela 11. Vlerësim i nevojave për investime për financimin e objektivave të Strategjisë së Energjisë (periudhë 10-vjeçare)

Investimi	Buxheti (milionë euro)	Burimi i financimit
Rehabilitimi i kapaciteteve ekzistuese prodhuese të Kosovës A dhe Kosovës B	390	Publik
Kapacitete të reja të energjisë së ripërtëritshme	1,300	Privat, publik, grante
Kapacitete të reja (të përbashkëta) në vendet fqinje	200	Publik, grante
Kapacitete akumulimi (bateri)	200	Grante, publik
Investime në rrjetin e transmisionit	90	Publik, grante
Investime në rrjetin e distribucionit	230	Privat
Investimet në efikasitetin e energjisë	350	Publik, privat, grante
Investimet në sistemin e ngrohjes	150	Publik, grante
Mbrojtja dhe furnizimi i konsumatorëve, me fokus te konsumatorët e cenueshëm	150	Publik, grante
Gjithsej	3,060	

Burimi: Ministria e Ekonomisë

Krahas strategjisë, edhe Draft Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë parasheh nevojat për investime për financimin e tranzicionit të gjelbër në Kosovë gjatë një periudhe pesëvjeçare. Këto nevoja vlerësohen në rreth 1.9 miliardë euro, ku pjesa më e madhe lidhet me promovimin e energjisë nga burime të ripërtëritshme, në shumën prej 900 milionë eurosh, dhe me rehabilitimin e dy termocentraleve Kosova A dhe Kosova B, në shumën prej 290 milionë eurosh.

¹⁵⁵ Ministria e Ekonomisë. [Strategjia për energji e Republikës së Kosovës 2022–2031](#).

Tabela 12. Nevojat për investime për financimin e tranzicionit të gjelbër –

Draft Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë (periudhë 5-vjeçare)

Politikat dhe masat	Buxheti (milionë euro)
Menaxhimi i kontrolluar i mbetjeve të ngurta	10
Promovimi i energjisë nga burimet e ripërditshme në sektorin e energjisë	900
Skema e vetëkonsumit	96
Ngrohja qendrore me energji diellore	121
Studimi i fizibilitetit për krijimin e sistemeve të ngrohjes qendrore në komuna të tjera	2
Skema e detyrimeve për eficiencë të energjisë	17
Rinovimi i objekteve banesore	65
Rinovimi i objekteve komerciale	30
Objekte me konsum pothuajse zero të energjisë	60
Certifikimi energjetik i ndërtesave	0
Përmirësimi dhe zgjerimi i sistemeve të ngrohjes qendrore të "Termokos" në Prishtinë dhe të ngrohjes qendrore në Gjakovë	47
Renovimi i ndërtesave të qeverisë qendrore	7
Renovimi i objekteve publike	10
Programet për informimin e konsumatorëve	0
Rritja e përdorimit të teknologjive eficiente në sektorin e banimit	14
Rehabilitimi i TC Kosova B dhe i një deri në dy njësi të TC Kosova A	290
Përmirësimi i sigurisë kibernetike në sektorin e energjisë	2
Modernizimi i rrjeteve dhe ulja e humbjeve në rrjet	127
Instalimi i kapaciteteve për akumulimin e energjisë përmes baterive, si dhe arsimimi dhe trajnimet për punëtorë të kualifikuar në fushën e teknologjive të qëndrueshme të energjisë	182
Gjithsej	1,980

Burimi: Qeveria e Kosovës

Vlerësimet e nevojave për investime në Strategjinë e Energjisë dhe në Draft Planin Kombëtar për Energji dhe Klimë shpalosin se, akarahas fondeve qeveritare, për ta financuar tranzicionin e gjelbër do të nevojitet të mobilizohen edhe burimeve të tjera financiare, përfshirë mbështetjen e donatorëve, institucioneve financiare ndërkombëtare dhe sektori privat. Këto nevoja janë evidentuar edhe në një raport të Bankës Botërore¹⁵⁶, sipas të cilit Kosovës do t'i nevojiten investime në vlerë prej rreth 2.9 për qind të BPV-së për të arritur objektivat e dekarbonizimit. Sipas të njëjtit raport, për realizimin e skenarit të zbutjes me emetime neto zero, Kosovës do t'i nevojiten investime në vlerë prej 760 milionë dollarësh deri në vitin 2030, si dhe 4.7 miliardë dollarë investime private dhe publike deri në vitin 2050. Nga kjo shumë, 86.7 për qind pritet të financohet nga sektori privat, kryesisht në sektorët e transportit, ndërtesave dhe energjisë elektrike, ndërsa pjesa e mbetur prej 13.3 për qind pritet të financohet me fonde publike.¹⁵⁷

156 Banka Botërore. [Raport për klimën dhe zhvillimin e vendit: Kosova](#). 2024.157 Banka Botërore. [Raport për klimën dhe zhvillimin e vendit: Kosova](#). 2024.

4.1.1 Roli i financimit publik dhe IFN-ve

Mekanizmat vendorë të financimit publik për tranzicionin e gjelbër në Kosovë vazhdojnë të jenë relativisht të kufizuar krahasuar me shkallën e investimeve të nevojshme. Në këtë kuadër, krahas alokimeve të rregullta vjetore buxhetore, Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) përbën një nga instrumentet ekzistuese të financimit publik, një institucion publik i pavarur i themeluar në vitin 2016 për ta përmirësuar qasjen në financim për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) përmes garancive kreditore që u ofron institucioneve financiare. Në vend të dhënies së drejtpërdrejtë të kredive, FKGK ul rrezikun kreditor për bankat dhe institucionet mikrofinanciare duke garantuar pjesërisht kreditë që u jepen bizneseve.¹⁵⁸ Në suazat e Pakos për rimëkëmbje dhe mundësi të gjelbra (GROW), të lansuar në vitin 2023, FKGK mbështet investimet në efikasitet të energjisë dhe energji nga burimet e ripërtëritshme, përfshirë izolimin e objekteve, pajisjet me efikasitet të lartë energjetike dhe projektet e energjisë së ripërtëritshme në shkallë të vogël, si instalimet solare, të erës, të biomasës dhe ato gjeotermale deri në 400 kW. Deri në prill të vitit 2026, garancitë e ofruara përmes këtij instrumenti arritën në rreth 3.2 milionë euro¹⁵⁹, çka tregon se shkalla e mbështetjes mbetet modeste në raport me nevojat e Kosovës për tranzicion.

Një tjetër instrument tjetër i rëndësishëm i financimit publik është Fondi i Kosovës për Efikasitet të Energjisë (FKEE), me rol kyç në mbështetjen e avancimit të tranzicionit energjetik të Kosovës përmes financimit të investimeve në efikasitet të energjisë, uljen e konsumit të energjisë dhe përmirësimin e performancës energjetike të ndërtesave. Deri në fund të vitit 2024, FKEE kishte mbështetur projekte të efikasitetit të energjisë në sektorin publik në vlerë prej rreth 13.59 milionë euro dhe kishte disbursuar rreth 10.35 milionë euro subvencione për sektorin e banimit, duke përfshirë 3,875 ekonomi familjare. Përmes këtyre ndërhyrjeve, FKEE ka ndihmuar në uljen e kostove të energjisë, përmirësimin e kushteve në objekte publike dhe private, si dhe krijimin e një modeli praktik financimi për zgjerimin e masave të efikasitetit të energjisë në suazat e tranzicionit më të gjerë të Kosovës drejt përdorimit të qëndrueshëm të energjisë.¹⁶⁰

Krahas instrumenteve të sipërpërmendura, Kosova është pajtuar të themelojë Bankën Zhvillimore për t'i adresuar hendeqet e financimit për investime afatgjata, që mund të shndërrohet në institucion kyç publik për financimin e tranzicionit të gjelbër. Themelimi i tij është pjesë e një marrëveshjeje financimi me Bankën Botërore në kuadër të Projektit për zhvillimin e sektorit financiar në Kosovë. Banka Zhvillimore e propozuar pritet të funksionojë si institucion jodepozitues që në fokus ka adresimin e hendeqeve financiare në segmente të ekonomisë që nuk janë të mbuluara mjaftueshëm nga tregu financiar. Me rëndësi të veçantë është se Banka Zhvillimore parashihet si instrument strategjik për mbështetjen e investimeve që lidhen me tranzicionin drejt një ekonomie me emetime të ulëta karboni, përfshirë energjinë nga burimet e ripërtëritshme, efikasitetin e energjisë, masat për qëndrueshmëri klimatike dhe investimet e nevojshme që eksportuesit të përshtaten me Mekanizmin e rregullimit kufitar për karbon (CBAM) të BE-së. Gjithashtu, Banka Zhvillimore pritet të ofrojë instrumente plotësuese financimi krahas FKGK-së, përfshirë financim me shumicë (ang. wholesale funding) të ndërmjetësuar përmes bankave komerciale, marrëveshje bashkëkreditimi, kredi sindikale dhe mekanizma bashkëinvestimi me institucione financiare private.¹⁶¹

158 Fondi Kosovar për Garanci Kreditore. [Misioni dhe vizioni](#). 2026.

159 Fondi Kosovar për Garanci Kreditore. [Zhvillimi i portofolit](#). 2026.

160 Fondi i Kosovës për Efikasitet të Energjisë. [Raport vjetor 2024](#).

161 Banka Botërore. [Dokument i vlerësimit të projektit për një kredi të propozuar për Republikën e Kosovës për Projektin për zhvillimin e sektorit financiar në Kosovë](#). 2024.

Nëse konceptohet dhe realizohet në mënyrë efektive, Banka Zhvillimore mund të luajë rol të rëndësishëm në mobilizimin e investimeve private dhe në adresimin e pengesave financiare që aktualisht kufizojnë investimet e gjelbra në Kosovë.

Megjithë rëndësinë e instrumenteve vendore, institucionet financiare ndërkombëtare (IFN) vazhdojnë të luajnë rol thelbësor në financimin e tranzicionit të gjelbër në Kosovë. Institucione si Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Banka Evropiane e Investimeve (BEI), KfW-ja dhe Bashkimi Evropian ofrojnë burime të rëndësishme financimi, asistencë teknike, garanci dhe mbështetje për përgatitje të projekteve. Përmes Instrumentit të asistencës së paraanëtarësimit (IPA) dhe Kornizës së investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF), Bashkimi Evropian është një nga burimet kryesore të financimit për tranzicionin energjetik të Kosovës duke ofruar mekanizma të ndryshëm financiarë, përfshirë grante dhe kredi. Deri në vitin 2025, Kosova ka përfituar rreth 299 milionë euro grante nga WBIF-i, në mbështetje të investimeve publike të vlerësuara në rreth 2 miliardë euro, përfshirë projekte të energjisë nga burimet e ripërtëritshme, eficiencës së energjisë dhe ngrohjes qendrore.¹⁶² Po ashtu, përmes Agjendës së saj të Reformave 2024–2027¹⁶³, Kosova ka siguruar qasje në Instrumentin e BE-së për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor.¹⁶⁴ Në vitin 2026, Komisioni Evropian filloi disbursimin e 61.8 milionë eurove si parafinancim për Kosovën në suazat e Planit për rritje, që përbën këstin e parë të një pakoje më të gjerë prej 882.6 milionë eurosh në grante dhe kredi me kushte të favorshme, të disponueshme deri në vitin 2027. Investimet në infrastrukturë kanalizohen përmes WBIF-it, duke krijuar një burim shtesë financimi për projektet strategjike në sektorin e energjisë dhe duke ndihmuar Kosovën të avancojë objektivat e Strategjisë për energji dhe të Planit kombëtar për energji dhe klimë (PKEK).¹⁶⁵ Disa nga reformat e parapara me Agjendën e reformave në fushën e energjisë dhe tranzicionit të gjelbër, që pritet të zbatohen deri në qershor të vitit 2026, përfshijnë miratimin e Ligjit për energjinë dhe Ligjit për energjinë elektrike, si dhe hartimin dhe miratimin e Udhërrëfyesit për tranzicion të drejtë. Nëse këto reforma miratohen brenda këtij afati, Kosova do të mund të përfitojë rreth 11 milionë euro.¹⁶⁶

4.1.2 Roli i financimit privat

Financimi privat, kryesisht përmes sektorit bankar komercial të Kosovës, pritet të luajë rol qendror në financimin e tranzicionit energjetik të vendit. Sektori bankar i Kosovës është i kapitalizuar mirë dhe ka shënuar rritje të qëndrueshme të kreditimit ndër vite, duke u shndërruar në burim të rëndësishëm financimi për bizneset që investojnë në energji nga burimet e ripërtëritshme dhe eficiencë të energjisë. Megjithatë, kreditimi vazhdon të jetë i përqendruar në një numër të kufizuar sektorësh. Në prill 2026, pjesa më e madhe e kredive të bankave komerciale ishte e orientuar drejt sektorit të shërbimeve (64,6%), pasuar nga prodhimi (19,2%) dhe ndërtimtaria (12,7%), ndërsa veprimtaritë e energjisë elektrike, gazit dhe ujit përbënin vetëm 1,1% të portofolit të përgjithshëm të kredive. Bujqësia përfaqësonte 1,7% të kreditimit të përgjithshëm, ndërsa minierat 0,6%. Përqindja e vogël e kreditimit të kanalizuar në sektorin e energjisë elektrike, gazit dhe ujit tregon se financimi nga bankat komerciale për investime në energji është ende i kufizuar në raport me shkallën e investimeve të nevojshme. Kjo mund të shpjegohet me faktin se projektet energjetike kërkojnë kapital të madh, kanë periudha më të gjata të kthimit të investimit dhe shoqërohen me rreziqe më të larta, si dhe me nevojën për ekspertizë të specializuar teknike dhe financiare. Ngjashëm, analiza e kredive për biznese sipas afatit të maturimit tregon se pjesa më e madhe e tyre kishin afat

¹⁶² Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor. [Kosova](#). 2026

¹⁶³ Qeveria e Kosovës. [Instrumenti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor. Agjenda e reformave e Kosovës](#). 2024

¹⁶⁴ Komisioni Evropian. [Instrumenti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor](#). 2024

¹⁶⁵ Bashkimi Evropian. [BE fillon parafinancimin prej 61.8 milionë eurosh për Kosovën në kuadër të Planit për rritje](#). 2026.

¹⁶⁶ Monitori i reformës. [Baza e të dhënave](#). 2026

maturimi prej dy deri në pesë vjet, përkatësisht 37,2%, ose prej pesë deri në dhjetë vjet, përkatësisht 33,6%. Ndërkohë, 18,5% e kredive kishin afat maturimi deri në një vit, ndërsa 5,2% kishin afat maturimi prej një deri në dy vjet. Vetëm 5,6% e kredive për biznese kishin afat maturimi më të gjatë se dhjetë vjet.¹⁶⁷

Figura 7. Gjithsej kredi për biznese sipas sektorit (prill 2026)





Figura 8. Kreditë për biznese sipas afatit të maturimit



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Kjo ka rëndësi, sepse investimet në energji nga burimet e ripërtëritshme, eficiencë të energjisë dhe infrastrukturë së energjisë elektrike zakonisht kërkojnë financim afatgjatë, për shkak të kostove të larta fillestare dhe periudhave të gjata të kthimit të investimit.

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) ka qenë një nga IFN-të më të angazhuara në mbështetjen e tranzicionit energjetik të Kosovës përmes ndërmjetësuesve financiarë vendorë, si bankat komerciale, me qëllim kanalizimin e financimit drejt ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) kryesisht për investime të gjelbra. Në vitin 2025, BERZH ofroi pako financimi për bankat komerciale në Kosovë në vlerë prej rreth 61 milionë eurosh, si kombinim linjash kreditore, mekanizmash të ndarjes së rrezikut dhe mbështetje për digjitalizim.¹⁶⁸ Një pjesë e konsiderueshme e këtyre fondeve është e dedikuar për investime në energji nga burimet e ripërtëritshme, eficiencë të energjisë, teknologji me përdorim efikas të burimeve dhe praktika të qëndrueshme biznesi, në kuadër të Kornizës së BERZH-it për tranzicion drejt ekonomisë së gjelbër (GET). Këto programe përplotësohen me grante të financuara nga BE-ja dhe asistencë teknike, duke ndihmuar në uljen e kostove të investimit dhe në mobilizimin e kapitalit privat.

Ndonëse investimet e nevojshme për tranzicionin energjetik dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike janë të konsiderueshme, kostot e mosveprimit do të ishin dukshëm më të larta. Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, nëse këto investime nuk realizohen, dëmet vjetore për ekonominë e Kosovës mund të arrijnë në rreth 4.2% të BPV-së në vitin 2050. Përveç pasojave ekonomike, ngjarjet ekstreme mund të shkaktojnë edhe humbje jetësh, lëndime dhe shkatërrim të mjeteve të jetesës.¹⁶⁹

¹⁶⁷ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. [Seritë kohore](#). 2026.

¹⁶⁸ Paketat e financimit të ofruara nga BERZH-i përfshinin: një pako financimi prej 20 milionë eurosh për NLB Banka Prishtina, një kredi prej 10 milionë eurosh për [Banka për Biznes](#), dhe një pako financimi prej 31 milionë eurosh për [Raiffeisen Bank Kosovo](#).

¹⁶⁹ Banka Botërore. [Raport për klimën dhe zhvillimin e vendit: Kosova](#). 2024.

5. Rekomandime

Bazuar në analizën dhe gjetjet e këtij raporti, rekomandimet në vijim paraqiten sipas institucioneve përgjegjëse për zbatimin e tyre.

Ministria e Ekonomisë

- **Të forcohet procesi i pajisjes me leje për energji nga burimet e ripërtëritshme përmes një One-Stop Shop efektive.** Kosova duhet ta avancojë One-Stop Shop ekzistuese për projekte të energjisë nga burimet e ripërtëritshme nga një mekanizëm për shkëmbim informacioni në një platformë funksionale koordinimi. Ajo duhet të përcjellë ecurinë e aplikimeve, të koordinojë institucionet, të monitorojë afatet, të identifikojë vonesat procedurale dhe t'i mbështesë investitorët gjatë procedurave të pajisjes me leje, pëlqim mjedisor, dhënies në shfrytëzim të tokës dhe kyçjes në rrjet.
- **Të zgjerohen masat e fokusuara në efikasitet të energjisë.** Kosova duhet të rrisë mbështetjen për rinovimin e objekteve banesore dhe atyre përmes FKEE-së, përfshirë izolimin, dritaret efikase, pompat termike, ndriçimin LED dhe modernizimin e sistemeve të ngrohjes. Këto masa do ta ulnin kërkesën për energji, do të zvogëlonin kostot për ekonominë familjare dhe do të përmirësonin sigurinë energjetike.
- **Të zgjerohet zbatimi i ankandeve konkurruese për energji nga burimet e ripërtëritshme dhe i skemave për prosumatorët.** Kosova duhet të institucionalizojë ankande të rregullta për energji diellore dhe atë të erës, duke i zgjeruar njëkohësisht skemat për prosumatorë për ekonominë familjare, NVM-të dhe institucionet publike.
- **Të synohen efikasiteti industrial dhe prodhimi.** Kosova duhet të krijojë skema të dedikuara të mbështetjes për ndërmarrjet prodhuese që investojnë në auditime të energjisë, pajisje efikase, panele solare në kulme, sisteme të akumulimit të energjisë dhe sisteme të menaxhimit të energjisë. Këto masa do të ulnin kostot e prodhimit dhe do ta përmirësonin konkurrueshmërinë në kuadër të CBAM-it.
- **Të hartohet një Udhërrëfyes kombëtar për tranzicion të drejtë.** Kosova duhet të krijojë një kornizë gjithëpërfshirës për menaxhimin e dimensioneve sociale dhe të tregut të punës të dekarbonizimit, veçanërisht në rajonet e varura nga thëngjilli. Kjo kornizë duhet t'i përcaktojë përgjegjësitë institucionale dhe të ndërthur politikat e energjisë, punësimit, mbrojtjes sociale dhe zhvillimit rajonal.
- **Të krijohet Fondi për Tranzicion të Drejtë.** Fondi për Tranzicion të Drejtë duhet të mbështesë ndërmarrjet, sidomos NVM-të, në financimin e investimeve për uljen e emetimeve dhe përmbushjen e kërkesave të pajtueshmërisë. Fondi duhet të ofrojë grante për dekarbonizim, të bashkëfinancojë auditimet e energjisë dhe planet për uljen e emetimeve, si dhe të mbështesë kostot e certifikimit dhe verifikimit.

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Inovacionit

- **Të forcohen kapacitetet për verifikim sipas CBAM-it.** Bizneset duhet të marrin informacion të qartë për verifikuesit e autorizuar të CBAM-it, ndërkohë që Kosova duhet të fillojë zhvillimin e kapaciteteve vendore të verifikimit përmes trajnimit dhe mbështetjes për akreditim. Kjo do ta ulte varësinë nga verifikuesit ndërkombëtarë dhe kostot e pajtueshmërisë.

KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut)

- **Të investohet në kapacitetet e rrjetit, akumulimin e energjisë dhe**

fleksibilitetin e sistemit. Zgjerimi i energjisë nga burimet e ripërtëritshme duhet të shoqërohet me investime në rrjetet e transmisionit dhe distribucionit, akumulimin e energjisë përmes baterive, menaxhimin digjital të rrjetit, mekanizmat e balancimit dhe shërbimet e fleksibilitetit. Në mungesë të këtyre investimeve, integrimi i kapaciteteve të reja të energjisë nga burimet e ripërtëritshme do të vazhdojë të kufizohet nga pengesat teknike.

KEK (Korporata Energjetike e Kosovës)

- **Të forcohen programet e rikualifikimit dhe aftësive të gjelbra.** Programet e rikualifikimit dhe ngritjes së aftësive ekzistuese duhet të zgjerohen për punëtorët në sektorët e thëngjillit, minierave dhe sektorët me intensitet të lartë energjie. Kosova duhet të mbështetet në nismat ekzistuese të trajnimit dhe ta përafrojë arsimin profesional me vendet e punës në sektorët e energjisë nga burimet e ripërtëritshme, efikasitetin e energjisë, akumulimit të energjisë, ekonomisë qarkore dhe prodhimit të gjelbër.
- **Të zbatohen masa aktive të tregut të punës për tranzicionin.** Kosova duhet të krijojë skema të pensionimit të parakohshëm, subvencionimit të pagave, shërbimeve të ndërmjetësimit në punësim dhe mbështetjes gjatë tranzicionit për punëtorët e prekur nga dekarbonizimi, veçanërisht në komunat me varësi të lartë nga thëngjilli dhe me shkallë të lartë punësimi në sektorin energjetik.

Dogana e Kosovës

- **Të krijohet infrastruktura për pajtueshmëri me CBAM-in.** Dogana e Kosovës duhet të identifikojë në mënyrë sistematike eksportuesit e mallrave ndaj të cilave zbatohet CBAM-i, t'i informojë ata për detyrimet e tyre sipas këtij mekanizmi dhe të ofrojë trajnime të konceptuara enkas për kërkesat e raportimit të BE-së. Kjo duhet të mbështetet nga një sistem i strukturuar për gjurmimin e të dhënave mbi emetimet e inkorporuara në sektorët përkatës.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK)

- **Të promovohet financimi i gjelbër dhe financimi për tranzicion.** Instrumentet e financimit të gjelbër duhet të zgjerohen përmes Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, bankave komerciale dhe institucioneve të tjera financiare. Produktet e dedikuara për financim të gjelbër dhe financim për tranzicion duhet të mbështesin teknologjitë me emetime të ulëta karboni, efikasitetin e energjisë dhe modernizimin industrial.

Rekomandime ndërinstucionale

- **Të miratohet legjislacioni i pamiruar akoma në fushën e energjisë dhe klimës.** Qeveria e Kosovës duhet t'i japë përparësi miratimit dhe zbatimit të Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë, legjislacionit të ri për efikasitetin e energjisë, si dhe akteve nënligjore të nevojshme për kornizën e performancës energjetike të ndërtesave.
- **Të hartohet një politikë industriale e gjelbër koherente.** Kosova duhet ta përdorë tranzicionin energjetik si gurthemel të një politike më të gjerë industriale të gjelbër që ndërthur energjinë e ripërtëritshme, efikasitetin e energjisë, modernizimin industrial, ekonominë qarkore, zhvillimin e fuqisë punëtore dhe konkurrueshmërinë e eksporteve.
- **Të forcohen politikat për mbrojtje sociale dhe nga varfëria energjetike.** Kosova duhet të përcaktojë një përkufizim të qartë ligjor të varfërisë energjetike dhe të forcojë mbështetjen e fokusuar në ekonominë

familjare të cenueshme që preken nga kostot e energjisë. Mbështetja duhet të përfshijë subvencione të dedikuara enkas, asistencë për efikasitet të energjisë dhe masa kompensimi në nivel komuniteti në zonat më të prekura.

- **Të përmirësohen koordinimi institucional dhe dialogu social.** Institucionet qendrore, komunat, sindikatat, bizneset dhe komunitetet lokale duhet të angazhohen në platforma të strukturuar dialogu. Kjo është thelbësore për rritjen e besimit, përmirësimin e transparencës dhe sigurimin që punëtorët dhe komunitetet e prekura të jenë pjesë e planifikimit të tranzicionit.
- **Të hartohet një udhërrëfyes vendor për tarifimin e emetimeve të karbonit.** Kosova duhet të përgatisë një udhërrëfyes për zbatim gradual të tarifimit të emetimeve të karbonit, potencialisht përmes një sistemi të tregtimit të emetimeve të harmonizuar me politikat klimatike të BE-së. Të hyrat duhet të orientohen drejt dekarbonizimit industrial, mbështetjes së tranzicionit dhe forcimit të kapaciteteve institucionale për monitorim, raportim dhe verifikim.
- **Të sigurohet që Banka Zhvillimore, nëse themelohet, të pozicionohet si institucion kyç për financimin e tranzicionit të gjelbër.** Banka Zhvillimore e planifikuar, nëse themelohet, duhet të ketë mandat të qartë për financim të gjelbër, me skema financimi për energji nga burimet e ripërtëritshme, efikasitet të energjisë, dekarbonizim industrial, gatishmëri për CBAM-in, qëndrueshmëri klimatike dhe infrastrukturën komunale.
- **Të mobilizohet financim i kombinuar me institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët.** Kosova duhet të kombinojë financimin publik, kreditë me kushte të favorshme, grantet e donatorëve dhe kapitalin privat në instrumente të financimit të kombinuar për energji nga burimet e ripërtëritshme, modernizim të rrjetit, akumulim të energjisë, ngrohje qendrore dhe rinovim të objekteve.

Reformat strukturore

- **Të zvogëlohet gradualisht varësia strukturore nga linjiti.** Kosova duhet ta ulë gradualisht varësinë nga thëngjilli përmes zgjerimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme, investimeve në akumulimin e energjisë, efikasitet të energjisë, integritet në tregun rajonal dhe masave për tranzicion të drejtë.
- **Të hyrat e ardhshme nga tarifimi i emetimeve të karbonit të përdoren për financimin e tranzicionit.** Nëse Kosova fillon së zbatuari tarifim vendor të emetimeve të karbonit, të hyrat duhet të mbeten në vend dhe të dedikohen për energji nga burimet e ripërtëritshme, efikasitet të energjisë, modernizim industrial, ekonomi familjare të cenueshme dhe masa për tranzicion të drejtë.
- **Të promovohet diversifikimi ekonomik rajonal.** Kosova duhet të krijojë një qasje të posaçme për zhvillimin rajonal të Obiliqit dhe komunave përreth, me qëllim uljen e varësisë nga KEK-u dhe nga punësimi në veprimtari të lidhura me minierat. Stimujt duhet të orientohen drejt prodhimit të pastër, shërbimeve të energjisë së ripërtëritshme, industrive digjitale dhe burimeve tjera alternative të punësimit lokal.
- **Të krijohet një strukturë e qëndrueshme e financimit të gjelbër.** Kosova duhet të ndërtojë një kornizë të përhershme të financimit të gjelbër që ndërthur buxhetin e shtetit, FKEE-në, FKKG-në, Bankën Zhvillimore, bankat komerciale, institucionet financiare ndërkombëtare dhe programet e donatorëve. Kjo kornizë duhet të përcaktojë rezultate

të matshme klimatike, raportim transparent dhe kritere të qarta për investimet e pranueshme.

- **Të harmonizohet tranzicioni energjetik i Kosovës me kornizat e BE-së dhe të Komunitetit të Energjisë.** Reformat afatgjata duhet të sigurojnë harmonizim me Pakon për energji të pastër të BE-së, obligimet që rrjedhin nga Komuniteti i Energjisë, Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor dhe rregullat e ardhshme të BE-së për tarifimin e emetimeve të karbonit. Ky harmonizim është thelbësor për integrimin e tregut, qasjen në financim të jashtëm, besimin e investitorëve dhe konkurrueshmërinë afatgjatë.

Shtojca

Tabela 1. Tabela 1. Eksportet e produkteve kosovare ndaj të cilave zbatohet CBAM, sipas sektorit, 2021–2025 (vlera në euro)

	Energji elektrike	Hekur dhe çelik	Alumin	Çimento	Plehra
2025	249,567	27,232,738	10,125,003	1,315	0
2024	11,829,815	32,404,386	11,861,674	44	0
2023	5,520,167	18,769,561	9,479,469	0	1,683
2022	45,014,962	20,037,445	7,556,012	393	159,551
2021	4,364,094	63,828,605	4,074,083	37	49,688

Tabela 2. Eksportet e energjisë elektrike të Kosovës drejt shteteve të përzgjedhura anëtare të BE-së, 2021–2025 (vlera në euro)

	2021	2022	2023	2024	2025
Sloveni	162,091	25,307,558	5,750	10,706,054	100
Danimarkë	2,593,675	16,331,788	5,514,417	1,060,884	213,375
Republikë Çeke	1,608,328	3,375,616	0	0	0
Greqi	0	0	0	62,877	36,092



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mesqeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr. 4, 10000 Prishtinë

Tel.: +383 38 609 339

info@institutigap.org

